



# **RAPORTI VJETOR 2019**

## PËRMBAJTJA

<b>HYRJE</b> .....	5
<b>I. FUNKSIONIMI I DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE</b> .....	5
<b>Misioni</b> .....	5
<b>Struktura Organizative</b> .....	Error! Bookmark not defined.
<b>Legjislacioni</b> .....	Error! Bookmark not defined.
<b>Vendimet e komiteteve 2019</b> .....	Error! Bookmark not defined.
<b>II. REALIZIMI I TË ARDHURAVE</b> .....	7
Grafik 1. Struktura e të ardhurave .....	10
Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2019 .....	10
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2019 sipas DRT-ve (000 leke) .....	12
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke) .....	13
Tabela 4. Të ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 leke) .....	13
Tabela 5. Të ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke) .....	14
Tabela 6. Krahësimi TAP sipas zerave (000 leke) .....	14
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke) .....	15
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore) .....	16
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit Rrugor (000 leke) .....	17
Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore .....	17
<b>III. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE</b> .....	18
Tabela 1: Përkrahimi i kontakteve dhe shërbimeve të ofruara .....	24
Tabela 2. Vertetime të leshuara në sportelet e shërbimit 2019 .....	24
Tabela 3. Vertetime të leshuara online nga portali e-albania 2019 .....	25
Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve: .....	25
Mbulimi mediatik .....	26
Qendra e Thirrjeve .....	27
<b>IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE</b> .....	33
<b>V. KONTROLI TATIMOR</b> .....	36
<b>VI. MENAXHIMI I RISKUT</b> .....	42
<b>VII. MBLEDHJA ME FORCË</b> .....	60
Grafik1. Struktura e borxhit sipas llojit të tatimit .....	61
Grafik 2. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2018 vs 2019 .....	62
Grafik 3. Moshë e borxhit .....	62

Grafik 4. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit .....	63
<b>VIII. RIMBURSIMI I TVSH-SË</b> .....	65
Tabela 1. Numri i kerkeseve dhe shumat e kerkuara per rimbursim per vitin 2019 .....	65
Tabela 2. Rimbursimet sipas DRT-ve viti 2019 .....	65
Tabela 3. Situata e rimbursimeve analitike per vitin 2019 .....	66
<b>XIX. HETIMI TATIMOR</b> .....	97
Grafik 1. Verifikimet e kryera në terren. ....	101
Grafik 3. Shkelje në vlerë sipas rajoneve .....	102
Tabela 1, Referime në prokurori .....	102
Grafik 4 Referime në prokurori sipas cdo DHT.....	103
Grafik 5 Referime të veprave penale në prokurori ndër vite .....	103
Grafik nr. 6 Referimet e rasteve sipas prokurorive.....	103
Tabela 2. Ndjekja e denoncimeve .....	104
<b>X. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE</b> .....	106
<b>XI.BURIMET NJEREZORE</b> .....	125
Tabela 1. Masat disiplinore të punonjësve Administratën Tatimore Qendrore për vitin 2019.....	130
Tabela 2. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 mujori I 2019.....	131
Tabela 2. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –mujori II 2019 .....	132
Tabela 3. Vlerësimet e 6-mujorit I 2019 të strukturës së Hetimit Tatimor në Administratën Tatimore.....	132
Tabela 4. Vlerësime 6 mujori II 2019 të strukturës së Hetimit Tatimor në Administratën Tatimore .....	132
Tabela 5. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore. ....	133
<b>XII. BUXHETI DHE FINANCA</b> .....	134
Tabela 1. Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve.....	134
Tabela 2. Raporti i Shpezimeve sipas artikujve buxhetore .....	134
Tabela 3. Projektet e investimeve .....	136
<b>XIII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PROKURIMEVE</b> .....	137
<b>XII. QENDRA E PAGESAVE</b> .....	142
<b>XVIII. DIBA</b> .....	144
<b>XVI. Zbatimi i rekomandimeve te nderkombetareve</b> .....	145
.....	

Raporti vjetor i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një dokument publik i cili ngarkohet në faqen zyrtare të internetit, [www.tatime.gov.al](http://www.tatime.gov.al)

<b>Shkurtime</b>	
<b>DPT</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
<b>DRT</b>	Drejtoria Rajonale Tatimore
<b>TVSH</b>	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
<b>TAP</b>	Tatimi mbi të Ardhurat Personale
<b>DPD</b>	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
<b>RPA</b>	Regjimi i Përpunimit Aktiv

## HYRJE

### I. FUNKSIONIMI I DREJTORISE SE PERGJITHSHME TE TATIMEVE

#### Misioni

Administrata Tatimore Qendrore administron mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe kontributeve shoqërore, duke nxitur përmbushjen vullnetare dhe duke kërkuar nga të gjithë kuptimin dhe respektimin e detyrimeve ligjore.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve është autoriteti shtetëror i specializuar, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për krijimin, sigurimin dhe mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe Kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë.

Institucioni është i organizuar në nivel qendror me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, përgjegjëse për hartimin, monitorimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave operacionale efikase në realizimin e misionit të institucionit. Në nivel rajonal, institucioni ka 14 Drejtori Rajonale Tatimore dhe në total në organikën e administratës tatimore shqiptare numërohen 1569 punonjës duke e renditur administratën tatimore si një nga institucionet ligj zbatues më të rëndësishme në vend.

Në këtë frymë, administrata tatimore nisur edhe nga praktikat e shumë vende anëtare të BE-së që kanë ndryshuar qëndrimin e tyre ndaj taksapaguesve, duke u larguar nga monitorimi i njëanshëm i përmbushjes së detyrimeve tatimore, u orientua drejt një marrëdhënieje proaktive dhe partneriteti me tatimpaguesit, duke investuar në forcimin e besimit të tatimpaguesve në përmbushje të nevojave të tyre. Përvoja tregon se tatimpaguesit e informuar kanë më shumë gjasa të përmbushin detyrimet e tyre në mënyrë të rregullt dhe kjo ka dhënë efekte të matshme e pozitive të cilat do t'i gjeni në treguesit statistikorë në këtë raport.

Të dhënat e vitit 2019 tregojnë se angazhimi serioz në luftën kundër informalitetit ka dhënë efektet e pritura të cilat shërbejnë si indikator për rritjen e besimit dhe sigurimin e një mjedisi të shëndoshë ekonomik.

Objektivat strategjikë nga të cilat AT udhëhiqet janë:

- Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare, përmes:
  - Ofrimit të shërbimeve cilësore dhe reduktimit të barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

- Rritjes së ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri.
- Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor, përmes:
  - Zbatimit të strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut ,
  - Përmirësimit të mëtejshëm të kontrollit tatimor dhe gjurmimit të mashtrimeve tatimore,
  - Mbledhjes efikase dhe efektive të borxhit ,
- Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore, përmes;
  - Aplikimit të metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një administratë tatimore moderne,
  - Zhvillimit të kapaciteteve dhe motivimit të punonjësve,
  - Mbajtjes së proceseve optimale dhe strukturës së Administratës Tatimore,
  - Zhvillimit dhe përmirësimit të partneriteteve,
  - Modernizimit dhe rinovimit të infrastrukturës,
  - Përmirësim në komunikimin dhe shërbimet ndaj tatimpaguesve në periudhën 2019 – 2018 ,
  - Kënaqësia nga shërbimet elektronike të tatimeve është dukshëm më e lartë në 2019 në të tëra aspektet e vlerësuara, si aksesit, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave,
  - Një rritje e konsiderueshme në vlerësimin për cilësinë e raportit të auditimit, si dhe sjelljen dhe etikën e inspektorëve,
  - Një rritje të ndjeshme në ndërgjegjësimin e tatimpaguesve për Modulin e Analizës së Riskut dhe përzgjedhjen për inspektim bazuar në të.

## II.REALIZIMI I TË ARDHURAVE

### Menaxhimi sipas objektivave

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2019 një ndër objektivat kryesor të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ka qenë:

- Rritja e pajtueshmërisë vullnetare,
- Rritja e performancës së mbledhjes të të ardhurave tatimore mbi parashikimet aktuale
- Përmirësimi dhe sigurimi i shërbimeve më të mira për tatimpaguesit,
- Reforma kundër informalitetit dhe fokusi në mirë-administrim,
- Trajnimi i vazhdueshëm për nënpunësit e të gjitha niveleve.

*Në arritjen e objektivave janë mbajtur në konsideratë:*

- Përmirësimi i administrimit të mbledhjes së tatimeve me efekte në rritjen e tyre.
- Efektet e paketës fiskale për vitin 2019.
- Forcimi i mbledhjes së taksave bazuar në strategjinë e riskut të pajtueshmërisë.
- Përzgjedhja dhe trajnimi i stafit të administratës tatimore.

### 2.1. Të ardhurat gjithsej

Administrata Tatimore Qendrore, për periudhën 12 mujore 2019, paraqet një performancë pozitive në mbledhjen e të ardhurave. Vendosmëria e administratës për të luftuar evazionin dhe ekonominë informale, si dhe fushatat sensibilizuese të ndërmarra kanë ndikuar në prirjen rritëse të të ardhurave.

### Struktura e të ardhurave

Struktura e mbledhjes së të ardhurave përbëhet nga:

- Të ardhurat tatimore neto përbëjnë **61 %** të të ardhurave totale neto
- Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përbëjnë **39 %** të të ardhurave totale neto.

### Të ardhurat e vitit 2019

Për vitin 2019, të ardhurat tatimore bruto gjithsej janë programuar 265.3 miliard lekë dhe janë realizuar 259.5 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 5.9 miliard lekë ose 2.2% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, me realizim të ardhurash 246.6 miliard leke, rritja e të ardhurave tatimore është 12.9 miliard lekë më shumë ose 5.2% më shumë.

Nga të dhënat statistikore të evidencës së realizimit të të ardhurave për këtë periudhë rezulton:

## **Të Ardhurat Tatimore**

Për vitin 2019, të ardhurat tatimore janë programuar 170.8 miliard leke dhe janë realizuar 165.3 miliard leke, me një mosrealizim prej 5.5 miliard leke ose 3.2% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën të ardhurat u realizuan 157.8 miliard leke, rezultatet janë në rritje me 7.5 miliard leke më shumë ose 4.8% më shumë.

## **Të Ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore**

Për vitin 2019, të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore janë programuar 94.6 miliard lekë dhe janë realizuar 94.2 miliard leke, me një rënie prej 0.4 miliard lekë ose 0.4% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, ku të ardhurat nga KSSHSH ishin 88.8 miliard leke, rezultatet janë në rritje me 5.4 miliard lekë më shumë ose 6.1 % më shumë.

### **2.2. Të Ardhurat Tatimore ndarë sipas llojit**

Realizimi i të ardhurave sipas llojit të tatimeve krahasuar me planin e vitit 2019 dhe faktin e vitit 2018, për periudhën Janar – Dhjetor 2019, bazuar në të dhënat statistikore, paraqitet si më poshtë:

#### **2.2.1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar**

Për 12 mujorin 2019, të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto) ishin programuar në vlerën prej 38.0 miliard lekë dhe janë realizuar në vlerën prej 26.0 miliard lekë, më një mosrealizim në vlerë prej 12.1 miliard lekë ose 31.7% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën u arkëtuan 36.5 miliard lekë, të ardhurat nga TVSH-ja neto janë arkëtuar 10.6 miliard lekë më pak ose 28.9 % më pak.

#### **2.2.2. Rimbursimi i Tvsh-së**

Për 12 mujorin 2019 rimbursimi për TVSH-në ishte programuar 19.0 miliard leke dhe është realizuar në vlerën 23.5 miliard lekë me një tejkalim prej 4.5 milion ose 23.7% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018 në të cilën janë rimbursuar 9.1 miliard lekë, rimbursimet janë realizuar 4.6 miliard leke ose 63.3% më shumë.

#### **2.2.3. Tatimi mbi Fitimin**

Të ardhurat tatimore nga Tatimi mbi Fitimin, janë programuar 33.5 miliard lekë dhe aktualisht janë arkëtuar 36.5 miliard lekë, me një mbirealizim prej 3.0 miliard lekë ose 8.9 % më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën u arkëtuan 34.4 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 2.1 miliard lekë më tepër ose 6.0% më shumë.

#### ***2.2.4. Tatimi mbi të Ardhurat Personale***

Tatimi mbi të ardhurat personale është programuar 41.9 miliard lekë dhe është realizuar 46.2 miliard lekë, me një mbirealizim prej 4.3 miliard lekë ose 10.3% më shumë.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në të cilin u arkëtuan 36.6 miliard lekë, të ardhurat nga ky lloj tatimi janë realizuar 9.7 miliard lekë më tepër ose 26.4 % më shumë.

#### ***2.2.5. Taksat Kombëtare dhe Tarifa***

Të ardhurat tatimore nga Taksat dhe Tarifa Kombëtare janë programuar në vlerën 15.4 miliard lekë dhe faktikisht janë arkëtuar 13.2 miliard lekë, me një mosrealizim 2.2 miliard leke ose 14.2% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën u arkëtuan 12.7 miliard leke, mbledhja e taksave është realizuar me një rritje prej 0.6 miliard leke ose 4.4% më shumë.

#### ***2.2.6. Taksa e Qarkullimit Rrugor***

Të ardhurat tatimore nga Taksat e Qarkullimit dhe Karburantit, të cilat janë programuar 21.0 miliard lekë, janë arkëtuar 18.8 miliard lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 2.2 miliard lekë ose 10.7% më pak.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, në të cilën u arkëtuan 18.3 miliard lekë, të ardhurat janë realizuar me rritje prej 0.4 miliard lekë ose 2.2% më shumë.

### **Struktura e të Ardhurave Tatimore për periudhën 12 mujore 2019**

Struktura e të ardhurave tatimore tregon se:

- TVSH-ja vazhdon të jetë kontribuesi kryesor në të hyrat publike me 30% të të ardhurave tatimore.
- Tatimi mbi të ardhurat personale përbën 28 % të të ardhurave tatimore,
- Tatimi mbi fitimin zë 22 % të të ardhurave tatimore,
- Taksa e qarkullimit me 11% të të ardhurave tatimore.

Grafik 1. Struktura e të ardhurave




Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2019

	E M E R T I M I	FAKTET		PLANI	Diferenca Fakt Plan		Diferenca 2019- 2018	
		2018	2019		+ ose -	Përqindje	+ ose -	Përqindje
	<b>D.P.TATIMEVE TOTAL (Bruto)</b>	<b>246,576,742</b>	<b>259,461,414</b>	<b>265,371,000</b>	<b>(5,909,586)</b>	<b>-2.23%</b>	<b>12,884,671</b>	<b>5.23%</b>
<b>A</b>	Te Ardhurat Tatimore gjithsej (arketim)	157,798,662	165,294,011	170,800,000	(5,505,989)	-3.22%	7,495,350	4.75%
<b>1</b>	TVSH (bruto)	50,903,912	49,456,618	57,000,000	(7,543,382)	-13.23%	(1,447,294)	-2.84%
	- TVSH (neto)	36,507,129	25,947,162	38,000,000	(12,052,838)	-31.72%	(10,559,967)	-28.93%
	- Rimbursimi i kryer	14,396,783	23,509,456	19,000,000	4,509,456	23.73%	9,112,673	63.30%
<b>2</b>	Tatim mbi Fitimin	34,413,962	36,484,399	33,500,000	2,984,399	8.91%	2,070,437	6.02%
<b>3</b>	Ardhura Personale	36,575,099	46,226,037	41,900,000	4,326,037	10.32%	9,650,938	26.39%
<b>4</b>	Taksat Nacionale	12,654,138	13,211,686	15,400,000	(2,188,314)	-14.21%	557,548	4.41%
<b>5</b>	Taksa e Qarkullimit Rrugor	18,347,259	18,754,453	21,000,000	(2,245,547)	-10.69%	407,193	2.22%
<b>6</b>	Lojrat e Fatit	4,614,389	910,263	2,000,000	(1,089,737)	-54.49%	(3,704,126)	-80.27%
<b>7</b>	Te tjera pa identifikuar	(0)	-0.02	0	-0.02		0.00	0.00%
<b>8</b>	Denimet Administrative	289,902	250,556	0	250,556		(39,346)	-13.57%
<b>B</b>	Te Ardhurat Tatimore (neto)	143,401,879	141,784,555	151,800,000	(10,015,445)	-6.60%	(1,617,323)	-1.13%
<b>C</b>	Kontributet e Sigurimeve	88,778,080	94,167,402	94,571,000	(403,598)	-0.43%	5,389,322	6.07%

D	D.P.TATIMEVE TOTAL (Neto)	232,179,959	235,951,958	246,371,000	(10,419,042)	-4.23%	3,771,999	1.62%
---	------------------------------	-------------	-------------	-------------	--------------	--------	-----------	-------

Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2019 sipas DRT-ve (000 leke)

	Te ardhura Total Bruto			Te ardhura Tatimore Neto			Sigurime Shoqerore		
	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%	Fakt	Plan	%
Berat	3,835,215	3,976,000	-3.54%	1,153,686	1,121,000	2.92%	2,263,621	2,470,000	-8.36%
Diber	3,422,034	3,626,000	-5.63%	1,249,457	1,504,000	-16.92%	1,979,436	2,080,000	-4.83%
Durres	15,415,772	15,082,000	2.21%	5,216,129	5,522,000	-5.54%	8,452,182	8,310,000	1.71%
Elbasan	7,016,795	6,915,000	1.47%	2,472,427	2,165,000	14.20%	4,181,616	4,300,000	-2.75%
Fier	9,237,979	9,449,000	-2.23%	3,426,366	3,394,000	0.95%	4,768,613	4,870,000	-2.08%
Gjirokaster	2,861,006	2,893,000	-1.11%	965,132	1,010,500	-4.49%	1,749,748	1,800,000	-2.79%
Korce	5,919,050	6,140,000	-3.60%	2,083,188	2,098,000	-0.71%	3,578,644	3,790,000	-5.58%
Kukes	2,165,657	2,204,000	-1.74%	811,427	728,000	11.46%	1,287,877	1,380,000	-6.68%
Lezhe	3,894,640	3,970,000	-1.90%	1,509,981	1,497,500	0.83%	2,290,582	2,400,000	-4.56%
Sarande	2,265,716	2,111,000	7.33%	1,037,213	942,000	10.11%	1,139,560	1,125,000	1.29%
Shkoder	5,992,155	6,157,000	-2.68%	1,719,869	1,769,000	-2.78%	3,937,217	4,090,000	-3.74%
Tirane	96,635,051	100,452,000	-3.80%	59,329,272	63,322,000	-6.31%	34,537,995	34,900,000	-1.04%
DTM	95,265,237	96,904,000	-1.69%	58,747,574	64,648,000	-9.13%	20,906,359	19,956,000	4.76%
Vlore	5,535,106	5,492,000	0.78%	2,062,835	2,079,000	-0.78%	3,093,955	3,100,000	-0.20%
<b>Total</b>	<b>259,461,414</b>	<b>265,371,000</b>	<b>-2.23%</b>	<b>141,784,555</b>	<b>151,800,000</b>	<b>-6.60%</b>	<b>94,167,402</b>	<b>94,571,000</b>	<b>-0.43%</b>

Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke)

	Fakti TVSH		Plan TVSH		Ndryshimi %	
	neto	bruto	neto	bruto	neto	bruto
Berat	224,445	642,353	265,000	650,000	-15.30%	-1.2%
Diber	270,722	463,863	421,000	463,000	-35.70%	0.2%
Durres	529,057	2,276,518	1,282,000	2,532,000	-58.73%	-10.1%
Elbasan	779,750	1,142,503	586,000	1,036,000	33.06%	10.3%
Fier	619,428	1,662,427	837,000	2,022,000	-25.99%	-17.8%
Gjirokaster	272,150	418,276	353,500	436,000	-23.01%	-4.1%
Korce	575,472	832,690	660,000	912,000	-12.81%	-8.7%
Kukes	290,852	357,205	245,000	341,000	18.71%	4.8%
Lezhe	569,877	663,955	591,500	664,000	-3.66%	0.0%
Sarande	328,784	417,728	389,000	433,000	-15.48%	-3.5%
Shkoder	320,782	655,852	425,000	723,000	-24.52%	-9.3%
Tirane	12,335,516	15,103,300	15,140,000	17,370,000	-18.52%	-13.0%
DTM	8,384,615	23,995,919	16,228,000	28,528,000	-48.33%	-15.9%
Vlore	445,714	824,029	577,000	890,000	-22.75%	-7.4%
<b>Totali</b>	<b>25,947,162</b>	<b>49,456,618</b>	<b>38,000,000</b>	<b>57,000,000</b>	<b>-31.72%</b>	<b>-13.2%</b>

Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 leke)

Tatimi mbi fitimin			
	Fakt	Plan	%
Berat	332,037	317,000	4.74%
Diber	363,357	447,000	-18.71%
Durres	1,992,172	1,870,000	6.53%
Elbasan	581,277	564,000	3.06%
Fier	869,347	928,000	-6.32%
Gjirokaster	168,131	197,000	-14.65%
Korce	464,502	486,000	-4.42%
Kukes	196,207	193,000	1.66%
Lezhe	364,211	410,000	-11.17%
Sarande	343,573	267,000	28.68%
Shkoder	425,911	446,000	-4.50%
Tirane	7,779,589	8,150,000	-4.54%
DTM	22,051,193	18,665,000	18.14%
Vlore	552,892	560,000	-1.27%
<b>Totali</b>	<b>36,484,399</b>	<b>33,500,000</b>	<b>8.91%</b>

Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	525,166	457,000	14.92%
Diber	540,618	470,000	15.03%
Durres	2,568,183	2,190,000	17.27%
Elbasan	1,018,751	910,000	11.95%
Fier	1,336,870	942,000	41.92%
Gjirokaster	476,274	373,000	27.69%
Korce	958,487	829,000	15.62%
Kukes	311,015	265,000	17.36%
Lezhe	547,505	466,000	17.49%
Sarande	335,096	271,000	23.65%
Shkoder	916,209	847,000	8.17%
Tirane	16,811,763	15,725,000	6.91%
DTM	18,915,374	17,345,000	9.05%
Vlore	964,725	810,000	19.10%
<b>Totali</b>	<b>46,226,037</b>	<b>41,900,000</b>	<b>10.32%</b>

Tabela 6. Krahاسimi TAP sipas zerave (000 leke)

		FAKT	PLANI	Diferenca PLAN - FAKT	
		2019	2019	+ ose -	Perqindje
	<b>Tatimi mbi te ardhurat personale</b>	<b>46,226,037</b>	<b>41,900,000</b>	<b>4,326,037</b>	<b>10.32%</b>
<b>1</b>	Tatimi mbi page nga listepagesa	22,279,842	23,860,438	(1,580,596)	-6.62%
<b>1,1</b>	Nga te punesuarit e Sektorit Publik	8,314,397	8,581,385	(266,989)	-3.11%
<b>1,2</b>	Nga te punesuarit e Sektorit Privat	13,965,445	15,279,053	(1,313,608)	-8.60%
<b>2</b>	Tatim mbi te Ardhurat nga Interesat	2,258,021	2,889,804	(631,783)	-21.86%
<b>3</b>	Tatim mbi te Ardhurat nga Qerate	4,048,843	4,176,560	(127,718)	-3.06%
<b>4</b>	Tatim mbi Fituesit e Lodrave te Fatit	68,084	90,454	(22,371)	-24.73%
<b>5</b>	Tatim mbi A.Personale Biznesi Vogel me xhiro 2-8 mln leke	2,450	9,819	(7,370)	-75.05%
<b>6</b>	Te tjera Tatime mbi te Ardhurat ne Burim	2,931,828	4,765,084	(1,833,257)	-38.47%
<b>7</b>	Tatimi mbi te ardhurat nga Dividentet dhe Aksionet	11,061,159	3,202,932	7,858,227	245.34%
<b>8</b>	Tatim mbi te Drejten e Autorit dhe Pronesise Intelektuale	345,697	346,255	(558)	-0.16%
<b>9</b>	Tatimi mbi Deklaraten Individuale Vietore te te ardhurave	367,001	258,653	108,348	41.89%
<b>10</b>	Tatim, shitja e pasurise se paluajteshme	2,724,467	2,080,000	644,467	30.98%
<b>11</b>	Tatim, trashegimia dhe dhurimi	138,647	220,000	(81,353)	-36.98%

Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	64,488	82,000	-21.36%
Diber	72,732	160,000	-54.54%
Durres	102,744	180,000	-42.92%
Elbasan	77,636	97,000	-19.96%
Fier	157,351	87,000	80.86%
Gjirokaster	43,863	87,000	-49.58%
Korce	68,670	123,000	-44.17%
Kukes	11,832	25,000	-52.67%
Lezhe	19,754	30,000	-34.15%
Sarande	13,979	15,000	-6.80%
Shkoder	37,244	51,000	-26.97%
Tirane	4,991,995	5,533,000	-9.78%
DTM	7,480,469	8,810,000	-15.09%
Vlore	68,929	120,000	-42.56%
<b>Totali</b>	<b>13,211,686</b>	<b>15,400,000</b>	<b>-14.21%</b>

Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore)

Struk.	Lloji i te Ardhurave	FAKTET		Diferenca	Përqindje
		2018	2019	+ ose -	
A	TAKSAT dhe TARIFA NACIONALE	12,654,138	13.211.686	557,548	4.41%
B	Tarifa Kombetare	1,380,774	953,174	(427,600)	-30.97%
C	Taksa Kombetare	11,273,364	12,258,511	985,147	8.74%
	Tarifa "BUXHETORE"	3,811,476	4,114,093	302,618	7.94%
1	Tarife sherbimi per Qarkullimin e Automjeteve te Huaja	89,872	92,132	2,260	2.51%
2	Tarife per rregjistrimin e Lojrave te Fatit , Llotarive , Kazinove	40,122	0	(40,122)	-100.00%
3	Tarife sherbimi per licensat radiotelevizive	16,587	16,386	(202)	-1.22%
4	Tarife sherbimi per perdorimin e aparateve televizive	1,203,624	1,259,905	56,281	4.68%
5	Tarife sherbimi per sherbimet e radiokomunikacionit	439,233	469,915	30,683	6.99%
6	Takse nacionale per lejen e ushtrimit te veprimtarise se	19,562	21,867	2,306	11.79%
7	Takse nacionale e karbonit per benzinen, benzolin dhe	2,368,155	2,514,832	146,677	6.19%
8	Takse nacionale per ambalazhet plastike te lengjeve te	1,755,029	2,210,654	455,625	25.96%
9	Takse mbi te drejten e perdorimit te truallit shtetedor nga	27,422	13,705	(13,717)	-50.02%
10	Taksë mbi Primet e shkruara	865,569	1,167,459	301,889	34.88%
11	Taksa per regjistrim fillestar per automjete luksoze	125,012	119,123	(5,889)	-4.71%
12	Taksa e pervitshme per automjetet luksoze	216,980	268,538	51,559	23.76%
13	Takse per automjetet e perdorura te transportit	4,023,232	4,091,900	68,669	1.71%
14	Tarife sherbimi per kalimin e kufirit me avion	1,690,673	1,836,643	145,969	8.63%
15	Taksa portuale	834	912	77	9.26%
16	Taksa e Akteve dhe e Pulles	227,754	221,278	(6,476)	-2.84%
17	Taksa e rentes minerare	1,273,792	899,033	(374,759)	-29.42%
18	Tarife per Sherbimet Konsullore	221,271	273,385	52,113	23.55%
19	Tarife Per paisjen me Deshmi Aftesie per Drejtim Automjeti	256,675	274,246	17,571	6.85%
20	Tarife per Regjitrin ne arsimin e Larte	522,053	221,457	(300,595)	-57.58%
21	Tarifa per pasaporte lundrimi te personave	1,886	2,008	122	6.48%
22	Tarifa per aktet administrative	702,434	616,754	(85,680)	-12.20%
23	Tarife , gjoba, interesa	7,820	4,437	(3,383)	-43.26%
24	Taksa te tjera , gjoba, interesa	370,023	729,210	359,187	97.07%
A+C	Gjithesej Taksa , tarifa nacionale + tarifa buxhetore	16.465.613	17.325.779	860,165	5.22%

Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkurllimit Rrugor (000 leke)

	Fakt	Plan	%
Berat	0	0	0.00%
Diber	0	0	0.00%
Durres	0	0	0.00%
Elbasan	0	0	0.00%
Fier	423,572	600,000	-29.40%
Gjirokaster	0	0	0.00%
Korce	2	0	0.00%
Kukes	0	0	0.00%
Lezhe	0	0	0.00%
Sarande	0	0	0.00%
Shkoder	0	0	0.00%
Tirane	17,333,886	17,400,000	0%
DTM	996,993	3,000,000	-67%
Vlore	0	0	0%
<b>Totali</b>	<b>18,754,453</b>	<b>21,000,000</b>	<b>-10.69%</b>

Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore

	Fakt	Plan	%
Berat	2,263,621	2,470,000	-8.36%
Diber	1,979,436	2,080,000	-4.83%
Durres	8,452,182	8,310,000	1.71%
Elbasan	4,181,616	4,300,000	-2.75%
Fier	4,768,613	4,870,000	-2.08%
Gjirokaster	1,749,748	1,800,000	-2.79%
Korce	3,578,644	3,790,000	-5.58%
Kukes	1,287,877	1,380,000	-6.68%
Lezhe	2,290,582	2,400,000	-4.56%
Sarande	1,139,560	1,125,000	1.29%
Shkoder	3,937,217	4,090,000	-3.74%
Tirane	34,537,995	34,900,000	-1.04%
DTM	20,906,359	19,956,000	4.76%
Vlore	3,093,955	3,100,000	-0.20%
<b>Totali</b>	<b>94,167,402</b>	<b>94,571,000</b>	<b>-0.43%</b>

## II. SHËRBIMI I TATIMPAGUESVE

I- Sektori i Regjistrimit ne DPT eshte perqendruar ne keto drejtime kryesore:

### **I.1-Regjistrimi dhe Azhornimi i Regjistrit Kombetar te tatimpaguesve.**

Gjate 12-mujorit 2019, sipas te dhenave te transmetuara nga QKB dhe atyre te ngarkuara ne sistem nga veprimet e kryera nga DRT-te ne rrethe per tatimpaguesit qe regjistrohen nga ana e tyre, rezulton se:

- Jane regjistruar si Tp. te rinj dhe hedhur ne Regjistrin Kombetar 16,404 tatimpagues nga te cilet 15,472 tp si biznes i vogel, 757 tp si biznes i madh dhe 175 (Ojf, ambulante etj).

Gjate ketij viti jane regjistruar nga DRT edhe 4,045 fermere ne zbatim te ligjit te TVSHdhe aktive nenligjore ne zbatim te tij.

Gjate vitit 2019 jane regjistruar ne pergjegjesine tatimore te TVSH-se 7,762 tp. ( nga regjistrimet e reja ardhur nga QKB dhe nga ndryshimet e pergjegjesive gjate vitit nga ana e DRT).

Numri i tatimpaguesve aktive, (qe kane te pakten nje pergjegjesi tatimore) ne Regjistrin Kombetar ne fund te vitit 2019, sipas te dhenave te nxjerra nga raportet e SIT, rezulton: 113,829 tatimpagues gjithesej. Ne kete shifer nuk jane perfshire 44,667 Fermere. Nga shifra gjithesej e aktiveve jane te regjistruara ne pergjegjesine tatimore TVSH 55,243 tatimpagues, nga te cilet 32,509 jane Tp. te biznesit te vogel, nga ku rezulton se tashme me shume se 50% e numrit te tatimpaguesve te TVSH-se e zene ata te BV.

Realizimi i funksionit te regjistrimit te subjekteve te reja nga sektori i asistences dhe regjistrimit ne DPT dhe nga DRT, eshte kryer nepermjet:

- bashkepunimit me QKB-ne per regjistrimin e bizneseve te reja dhe  
- mbikqyrjes se regjistrimit te tatimpaguesve te kategorise OJF-ve , Ambulante, Fermere etj..., qe kryen nga Drejtorite Rajonale.

Vlen per tu theksuar se procesi i transmetimit dhe procesimit te te dhenave per regjistrimet e reja nga QKB ne DPT per vitin 2019 ka ecur normalisht dhe nuk jane paraqitur probleme.

### **I.2 -Sherbimi ndaj tatimpaguesve, dhe dhenia e informacionit per institucione te tjera.**

Gjate ketij viti eshte bere nje pune e konsiderueshme ne perpunimin e shkresave per dhenien e informacionit institucioneve shteterore, tatimpaguesve e personave te ndryshem, si dhe eshte dhene pergjigje çdo emaili te brendshem apo te jashtem qe lidhet me funksionin e regjistrimit per sqarimin e procedurave dhe detyrimeve ligjore.

Fakti qe vetem ne sektorin e regjistrimit ne DPT gjate vitit 2019 kane hyre dhe jane perpunuar mbi 2000 shkresa, bazuar kerkesave te institucione te ndryshme (ILDKPKI, KPK , KJK etj) tregon per nje volum te konsiderueshem pune brenda ketij afati kohor.

Nga ana sektorit te regjistrimit gjate vitit 2019 jane monitoruar veprimet e DRT-ve qe ato kryejne punonjesit e regjistrimit ne teresi ne sistem sipas rregullores se brendshme per ndryshimin e te dhenave te tatimpaguesve, ku konkretisht pjesa me e madhe eshte ne shtimin e pergjegjesive tatimore (Tatim ne burim 7,361 raste, TVSH 3,074 raste) dhe riaktivizime nga statusi pasiv ne aktiv 621 .

### **I.3-Transferimi I tatimpaguesve nga nje DRT ne nje DRT tjeter**

Transferimi i tatimpaguesve nga nje drejtori rajonale tatimore ne nje tjeter jane veprime qe kryhen nga Administrata tatimore ne baze te ndryshimeve te selise qe kane kryer tatimpaguesit ne QKB gjate nje viti. Ky transferim iniciohet mbas ndryshimit qe ben tatimpaguesi prane QKB-se. Te dhenat nxirren nga Sistemi per te dhenat e transmetuara nga QKB dhe Sektori i Regjistrimit pasi kryhen veprimet perkatese per ndryshimin e DRT ne Sistem njofton çdo DRT per ndryshimet e ndodhura.

Ne sistemin e Ri Tatimor jane lehtesuar veprimet e transferimit ten je tatimpaguesi nga nje DRT ne nje tjeter. Ndryshimi final I ketij kalimi behet nga sektori I regjistrimit ne DPT duke monitoruar dhe veprimet operative qe kryejne DRT per levizjen e dosjes se tatimpaguesit. Gjate vitit 2019 jane transferuar (ndryshuar DRT ne Sistem) 656 tatimpagues dhe ky informacion publikohet e perditesohet ne faqen tone te intranetit ne ndihme dhe te Drejtorive te tjera ne DPT.

Ne realizimin e procesit te transferimit, bazuar edhe ne manualin e sherbimit te miratuar nga DPT per kete qellim nuk mund te transferohen ata tatimpagues qe jane ne procedura kontrolli. Kjo bazuar edhe kerkesave dhe zhvillimeve te bera ne Sistemin e ri tatimor.

Pra nje tatimpagues qe eshte ne procedura kontrolli nuk mud te transferohet ne nje DRT tjeter pa u mbyllur çeshtja e kontrollit dhe te hidhen rezultatet e tij ne sistem.

Gjate vitit 2019 ka patur levizje te tatimpaguesve nga DRT ne NJTM dhe anasjelltas te cilat behen per nevoja administrimi me te mire me urdher dhe rregullore te Drejtorit te Pergjithshem te tatimeve. Konkretisht kane dale nga regjistri i DR NJTM 309 tp., dhe kane hyre 217 tatimpagues.

Realizimi i transferimeve te kryera nga ndryshimi i selise se tatimpaguesit ne QKR dhe i levizjeve te tatimpaguesve (Hyrje-daljeve) nga NJTM jep numrin e tatimpaguesve gjithesej, qe ka nje DRT ne nje periudhe te caktuar.

#### **I.4-Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve**

Kalimi ne pasiv i tatimpaguesve per vitin 2019 ka qene nje process qe pothuajse kryhet ne menyre automatike ne sistemin informatik te DPT dhe ne pak raste nga DRT ne rrethe. Nga te dhenat qe administrojme ne fund te vitit 2019 rezultojne te regjistruar ne regjistrin pasiv (progressive) gjithesej 124,744 tatimpagues, nga te cilet kane kaluar gjate ketij viti 10,748 tatimpagues.

Perditesimi dhe azhornimi I regjistrit Pasiv behet nepermjet – kalimit ne pasiv nga veprimet e pezullimin te aktivitetit qe kryhen tatimpaguesi ne QKB, dhe kalimi automatik nga sistemi edhe i tatimpaguesve qe kane periudhe mosdeklarimi dhe deklarimin pa veprimtari per me shume se 12 periudha mujore te njepasnjeshme dhe tashme kjo procedure per ekzekutimin e procesit te kalimit automatic ne Pasiv nga Sistemi, funksionon rregullisht per çdo fund muaji.

Te gjitha DRT per Tatimpaguesit qe kalojne ne regjistrin pasiv, nga sistemi apo nga ana e tyre , me nje liste te detajuar u jepen per ndjekje Drejtorive dhe sektoreve te tjere si Drejtorise se Kontrollit dhe asaj te Hetimit te DRT per ndjekje te vazhdueshme nga ana e tyre. E njejta procedure ndodh edhe kur tatimpaguesit riaktivizohen perseri.

Ne fillim te vitit 2019 ne Sistemin e Ri Tatimor, bazuar ndryshimeve te ligjit te procedurave tatimore u bene zhvillime per riaktivizimin automatik nga sistemi (kalimi nga pezulluar/pasiv ne aktiv) i tatimpaguesit kur ata kryejne veprimin e heqjes se pezullimit ne QKB. Gjate vitit jane kryer riaktivizime autometike te ardhura nga QKB per 5503 tatimpagues.

Lista e tatimpaguesve passive e perditesuar eshte e publikuar ne faqen e ëeb-it te DPT, e cila sherben per verifikim dhe konsultim dhe nga ana e tatimpaguesve per qellime te transaksioneve te tyre.

Theksojme se procedurat e kalimit ne pasiv tashme jane qartësuar dhe thjeshtuar duke bere te mundur pastrimin e regjistrit nga tatimpaguesit jo aktive dhe perditesimin e te dhenave ne Regjistrin e Tatimpaguesve.

Drejtoria e Sherbimit ne DPT, vazhdimisht bashkepunon me QKB dhe Palen Furnitore per problemet qe mund te shfaqen per kalimin e tatimpaguesve ne statusin pasiv, si dhe orienton DRT ne rrethe per zgjidhjen e problemeve, si dhe bazuar veprimeve nga QKB sqaron tatimpaguesit per statusin e tij.

### **I.5-Azhornimi i ndryshimeve ne regjistrim, qe behen ne QKR**

Baze e azhornimit real, te sakte dhe te shpejte te te gjitha te dhenave te ndryshuara qe kryejne tatimpaguesit ne regjistrin tregtar apo dhe kerkesave te reja, jane Zhvillimet e vazhdueshme qe ndodhin ne Sistemet Elektronike te DPT dhe QKB.

Procesi i azhornimit te ndryshimeve ne regjistrim (transmetimi nga QKB- ne DPT) qe bejne tatimpaguesit ne QKB, dhe qe jane pjese e ndryshimeve te te dhenave ne regjistrin tregtar, tashme kryhet pothuajse normalisht.

Ne azhornimin apo perditesimin e ndryshimeve qe ben tatimpaguesi ne QKB per vitin 2019 ka ndikuar zbatimi I Marreveshjes se bashkepunimit si dhe protokollit elektronik te shkembimit te te dhenave midis dy institucioneve DPT-QKB (firmosur ne shtator 2019), ku te dhena shtese dhe informacion me i gjere qe gjendet ne QKB, duhet te transmetohet e pasqyrohet edhe ne dosjen elektronike te tatimpaguesit ne Sistem. Konkretisht per kete vit jane permiresuar disa te dhena:

- 1-Riaktivizimi ne menyre automatike nga Pasivi ne Aktiv ne Sistemin tatimor bazuar veprimeve te heqjes se pezullimit te aktivitetit ne QKB
- 2- Madhesia e pershkrimtit te aktivitetit ne Sistemin e tatimeve eshte mbi 500 karaktere,
- 3-Ri konceptimi i informacionit qe do te dergohet per personat e lidhur brenda tatimpaguesit/ shoqerive

Bazuar Marveshjes DPT-QKB jane bere disa zhvillime ne sistem nga Pala mirembajtese per lehtesimin e menyres se komunikimit dhe shkembimit te te dhenave me QKB konkretisht;

- 1- Dergimi I subjekteve /tatimpaguesve qe kane detyrimin per paraqitjen e pasqyrave financiare,
- 2- Dergimi I situates tatimore te tatimpaguesit (per tu verifikuar nga QKB) ne menyre elektronike,

3- Marrja e të dhënave dhe informacionit nga QKB mbi procedurat e bashkimit, ndarjes dhe transformimit të shoqërive apo regjistrimit të subjekteve, në mënyrë elektronike, (në procedura për t'u dërguar të dhënat nga QKB)

Keto të dhëna do të shfaqen në sistem dhe do të ndihmojnë përdoruesit për të marrë një informacion më të shpejtë dhe më të saktë për qëllim të punës së tyre.

Në punën e përditëshme kur konstatohen probleme nga sektori përkatës në DRT, ato behen prezent në DPT për zgjidhje, sipas rastit dhe me Palen Furniture që mirëmban Sistemin e Ri, për të dhënë zgjidhje praktike çdo rast të konstatuar.

Gjatë vitit 2019, në funksion të përmirësimit të praktikës së deritanishme të shkëmbimit të disa të dhënave midis QKB-DPT, por edhe kërkesave shtesë nga ato dy palët, në bashkëpunim me Drejtorinë e TIK AKSHI këtu, janë kryer disa takime me QKB për problemin që kemi patur për zbatimin e protokollit elektronik të Ri, me mundësi për përcaktimin kushteve të standarteve që duan zhvillim e të dy sistemeve si në QKB edhe në DPT.

#### **I.6- Çregjistrimi i tatimpaguesve në sistemin e Ri Tatimor**

Gjendja e tatimpaguesve të regjistruar progresive në Sistemin e Ri Tatimor në fund të 2019 rezultoi 59,288 tatimpagues.

Për vitin 2019 u finalizuan të regjistruar në Regjistrin Kombëtar të DPT rreth 3,872 tatimpagues.

Procesi i regjistrimit të tatimpaguesit finalizohet në DRT përkatëse. Certifikatat e regjistrimit (kopje) të lëshuara nga QKB aktualisht dërgohen direkt në DRT përkatëse në bazë të marrëveshjes që kemi rënë dakort me QKB, pasi aty do të kryhen dhe veprimet konkrete për regjistrimin e tatimpaguesit edhe nga Regjistri i tatimpaguesve të DRT. Janë bërë zhvillimet në sistem

Në vitin 2019 regjistrimi i tatimpaguesve bazuar nga problemi i dërguar nga DRT në rrethë ka dhe vështirësi të veta, pasi finalizimi i regjistrimit për disa raste, nuk mund të realizohet nga punonjësit tanë në DRT.

Kjo vjen edhe si rezultat;

-I mospërbushjes së detyrimeve ligjore nga ana e tatimpaguesve duke mos paguar të gjitha detyrimet dhe dorëzuar të gjitha deklaratat tatimore.

- I mosveprimit te punonjesve te Kontrollit per te vleresuar deklaratat dhe llogarine perkatese te Tatimpaguesit, dhe I mosmiratimit te çregjistrimit nga ana e tyre, per te cilat pengojne çregjistrimin e tij.

Detyra per vitin 2020, te cilat pasqyrohen edhe ne Planin Operacional te DPT 2020:

- 1- Ndjekja e zbatimit te Marreveshjes se bashkepunimit me QKB dhe i Protokollit te Shkembimit Elektronik te te dhenave midis QKB-DPT, ne bashkepunim me drejtorine Ligjore, drejtorine e TI, per te pasqyruar ne te ndryshimet ligjore te ndodhura.
- 2- Monitorimi i procedurave te aktivizimit te tatimpaguesve nga statusi Pasiv ne Aktive, per Tp., qe riaktivizohen ne QKB, nepermjet zhvillimeve ne sistem nga Pala furniture.
- 3- Monitorimi I dergimit te informacionit te derguar nga QKB per shoqerite qe likujdohen, bashkohen, transformohen,
- 4- Lehtesimi I procedurave te regjistrimit per tatimpaguesit qe regjistrohen prane Administrates tatimore.

Gjate 12-mujorit 2019, puna e Drejtorise te Sherbimit te Tatimpaguesve, eshte perqendruar ne konsolidimin, rritjen e nivelit dhe lehtesimin e sherbimit ndaj tatimpaguesve. Kjo eshte arritur duke ndjekur realizimin e detyrave dhe objektivave te percaktuara, ne Planin Operacional te vitit 2019, si dhe detyrave te realizuara ne funksion te reformave te DPT-se.

## **II - Asistenca dhe shërbimi për tatimpaguesit**

Drejtoria e Shërbimit për Tatimpaguesit është përgjegjëse, për sigurimin e ofrimit të sherbimit cilesor dhe asistencës për të gjithë tatimpaguesit, për menaxhimin e regjistrimit të tatimpaguesve përfshirë azhurnimet e tij, me qellim permbushjen vullnetare te detyrimeve ligjore.

II. 1. Sektori i Asistencës dhe Shërbimit për Tatimpaguesit, si pjesë e Drejtorisë së Shërbimit për tatimpaguesit në DPT, për vitin 2019 është fokusuar në zbatimin e detyrave dhe aktiviteteve sipas Planit Operacional 2019, me qëllim përmirësimin e shërbimeve që i ofrohen tatimpaguesve, me qëllim reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore, si dhe detyrave të ngarkuara në funksion të reformave të ndërmarra nga DPT.

Objektivat e këtij Sektori për vitin 2019 ishin:

Rritja e nivelit te informimit dhe ndergjegjesimit te tatimpaguesve per ne funksion te permbushjes se detyrimeve te tyre tatimore

Perfshirja e shërbimeve të reja online.

Sherbim dhe asistencë cilësore për tatimpaguesit

II.2 Gjatë vitit 2019, sportelet e Shërbimit kanë pritur rreth 218.000 vizitorë, të cilët janë tatimpagues apo individë, të cilëve iu është ofruar shërbim dhe asistencë në lidhje me kërkesat e tyre për informacion, në lidhje me ndryshimet e Legjislacionit tatimor, për kuptimin e përgjegjesive tatimore, deklaratimit elektronik, pajisjes me vërtetime nepermjet portalit e-albania etj.

Tabela 1: Përshkrimi i kontakteve dhe shërbimeve të ofruara

<b>Numri i njoftimeve</b> i dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	179 270
<b>Numri i takimeve të mbajtura</b> me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar.	158
<b>Numri total i vizitave këshilluese</b> të përfunduara	55 827
<b>Numri i seminareve edukues</b> të realizuar	80
<b>Numri total i tatimpaguesve të asistuar ( ballë për ballë )</b>	217 743

Shërbimi për tatimpaguesit është orientuar drejt përmirësimit të shërbimeve dhe rritjes së cilësisë së tyre. Gjatë vitit 2019 janë shtuar edhe 2 shërbime të tjera të DPT, që ofrohen automatikisht për tatimpaguesit nëpërmjet portalit e-albania, përveç 9 shërbimeve që ofrohen elektronikisht prej Tetor 2017. Këto 11 shërbime përbejnë 91% të totalit të shërbimeve, krahasuar me ato që ofrohen në sportele.

**Përshkrimi i vërtetimeve të lëshuara nga funksioni i shërbimit dhe online**

Tabela 2. Vërtetime të lëshuara në sportelet e shërbimit 2019

<b>Vërtetim për posedim mjetesh</b>	253
<b>Konfirmim listepagesash</b>	414
<b>Lëshim certificate residence</b>	178
<b>Vërtetim për individ të përgjigjësuar</b>	22,996
<b>Vërtetim për pagim detyrimesh</b>	3,598
<b>Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti</b>	1,250
<b>Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin</b>	5,236
<b>Vërtetim për përgjegjësitë tatimore</b>	578
<b>Vërtetim për regjistrim të investitorit</b>	-
<b>Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)</b>	758

Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit	1,261
<b>Totali</b>	<b>36,522</b>

Tabela 3. Vertetime te leshuara online nga portali e-albania 2019

Vërtetim për pagim detyrimesh	12 672
Konfirmim listepagesash	166 990
Leshim certificate residence	2 994
Vërtetim për individ të paregjistruar	7 137
Vërtetim për pagimin e kontributeve nga subjekti	8 151
Vërtetim për pagimin e kontributeve për individin	137 302
Vërtetim për përgjegjësitë tatimore	2 336
Vërtetim për posedim mjetesh	220
Vërtetim për regjistrim të investitorit	55
Vërtetim statusi (aktiv, pasiv përfshirë datën)	4 194
Vërtetim xhiro për 3 vitet e fundit	4 711
<b>Totali</b>	<b>346 762</b>

#### Informimi, edukimi dhe ndërgjegjësimi i tatimpaguesve:

- 287 njoftime informuese dhe ndërgjegjësuere në web dhe kanalet e komunikimit të DPT në media sociale, në një frekuencë thujse të përditshme, të cilat janë përcjellë gjerësisht në median tradicionale dhe atë online.
- 11 video informuese mbi ndryshimet ligjore dhe aplikimet e tyre;
- 15 njoftime të personalizuar për tatimpaguesit në llogarinë e tyre elektronike në e-filing, për çështje të interesit të rëndësishëm për ta.
- 179,270 njoftime dërguar tatimpaguesve me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar;
- 158 takime të mbajtura me tatimpaguesit me qëllim parandalimin e mashtrimit dhe nxitjen e korrektimit vullnetar;
- 55,827 Vizita këshilluese tek tatimpaguesit e rinj dhe ata ekzistues;
- 217,743 tatimpagues të asistuar ( ballë për ballë );

- 80 Seminare edukues me tatimpagues dhe kontabilistë, si dhe me tatimpaguesit e rinj
- Plan komunikimi për Paketën Fiskale 2019, i cili përfshiu: 14 takime informuese; 40 njoftime në web dhe FB, 10 kronika dhe intervista në media; me shumë se 5.000 vizita informuese në vendet e ushtrimit të aktivitetit të subjekteve; përditësimin e Legjislacionit tatimor të publikuar në faqen e internetit, materialit të publikuar në Platformën e informimit (set prej 11 materialesh informuese (broshura dhe video) për tatimpaguesit sipas kategorive dhe fashave të qarkullimit). Plan komunikimi si pjesë e Planit Sektorial për Bar-Restorante : 14 takime informuese në çdo DRT me grupet e interesit (tatimpagues, shoqata kontabilistesh, eksperte kontabel etj), vizita informuese etj.

### **Sherbimi ndaj tatimpaguesit dhe bashkëpunimi me institucione të tjera.**

- Gjatë vitit 2019 është shtuar prezenca e DPT edhe në Qendrat ADISA Shkoder dhe Tirane, përveçse në Krujë, Kavajë, Fier dhe Gjirokastrë. Sherbimi i ofruar në këto Qendra për individët dhe subjektet nuk ka asnjë ankesë të regjistruar për institucionin e DPT-së. Këto shërbime do të ofrohen në të ardhme e afërt edhe në Qendra të tjera ADISA, si në Lezhë, Elbasan etj.

Gjithashtu, u krijuan sportele të shërbimit për tatimpaguesit e rinj, por jo vetëm, edhe pranë Njësisë të Qeverisjes Vendore, përkatësisht pranë bashkive Durrës, Korçë, Elbasan etj.

### **Mbulimi mediatik**

Mbulimi mediatik i njoftimeve, deklaratave për shtyp dhe komunikimeve të tjera zyrtare të DPT, ka qenë shumë i mirë, ku mediat e profilizuara kanë përcjellë çdo njoftim të publikuar në faqen tonë web dhe faqen zyrtare në Fb, ndërsa konferencat për shtyp janë mbuluar në të gjitha mediat me kronika kryesore tradicionale, me transmetim në kohë reale në News24; ReportTv, OraNews; FaxNews si edhe nga portalet. Po ashtu kemi informuar përmes intervistave dhe kronikave informative përgjatë gjithë vitit, kryesisht mbi ndryshimet ligjore, Planin operacional të DPT (sipas planeve sektoriale përkatëse), si edhe mbi Reformën e Fiskalizimit. Janë rreth 50 prani të përfaqësuesve të DPT në media televizive, gjatë viti 2019.

## Rrethanat historike të krijimit

- ☐ Reformë tatimore për përmbushjen e misionit të Administratës Tatimore që lidhet me:
  - Përmbushjen e detyrimeve tatimore nga subjektet/tatimpaguese, mbështetur në objektiva të parashikuara në Programin Ekonomi Fiskal të Qeverisë.
  - Përmirësimin e klimës më biznesin,
  - Komunikim elektronik me subjektet dhe publikun tatimpagues .
  - Shërbime elektronike moderne mbështetur në sistemin GoAutoDial,
- ☐ Strukturë organizative e orientuar nga OECD, që funksionon me një Qendër të vetme Thirrje.
- ☐ Më 16.11.2016 krijohet Drejtoria e Qendrës së Thirrjeve (DQTH).

## Baza ligjore e veprimtarive

1. Ligj Nr.9920, datë19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet:

- 16 “Struktura e Administratës Tatimore Qëndrore”
- 24 “Dhënia e informacionit tatimor”
- 28 “Informimi i publikut”
- 30 “E drejta për informim dhe asistencë”
- 31 “E drejta për konfidencialitetin e të dhënave”
- 34 “E drejta për informim”

2. Rregullore e Brendshme e DPT-së
3. Manuali i Qendrës së Thirrjeve.
4. Plan strategjik dhe operacional vjetor 2019
5. Sistemi elektronik GoAutoDial

## STRUKTURA ORGANIZATIVE

1. Drejtoria e Qendrës së Thirrjeve është pjesë përbërse e organigramës së strukturës të DPT-së,
2. Përbërja e DQTH: 2 sektor; 17 punonjës:

- Drejtor drejtorie        1
- Përgjegjës sektori    2
- Specialist                14

(3 studentë ekselence, 2 punonjës me transferim në DRT, 1 vend bosh)

### **Objektivat strategjike të Drejtorisë për vitin 2019**

I- Garantimi dhe zgjerimi i komunikimit elektronik me tatimpaguesit për përmbushjen vullnetare të detyrimeve tatimore dhe informimin e tyre për lehtësimin e procedurave dhe përjashtimin e disa veprimtarive nga taksimi me synim zhvillimin e disa sektoreve si bujqesi, agroturizem, farmaceutike, hoteleri, etj të stimuluar nga ndryshimet ligjore të parashikuara në Paketën Fiskale 2019.

II- Azhurnimi i ndryshimeve ligjore dhe zbatimi i drejte i legjislacionit tatimor që lidhet me komunikimin e ATQ me tatimpaguesit.

III- Progresi organizativ i ATQ dhe zhvillimi i kapaciteteve administrative.

### **Objektivat operacional të Drejtorisë për vitin 2019**

I- Rritjen e kontakteve me tatimpaguesit me 15% në krahasim me vitin 2018.

Thirrjet hyrëse	10,000
Thirrjet dalëse	52,000
Rritjen e numrit të fushatave të realizuara	40
Komunikimi në Live Chat	6,000
Emaile me problematika	40

II- Shtimin e treguesve të performancës për Qendrën e Thirrjeve dhe rritjen e besueshmërisë së rolit të saj brenda dhe jashtë Administratës Tatimore.

III-Organizimin e trajnimeve profesionale për rritjen e kapaciteteve në Drejtorinë e Qendrës së Thirrjeve

## Aktivitetet e realizuara dhe ne proces gjate vitit 2019

Rritjen e kontakteve me tatimpaguesit me 15% në krahasim me vitin 2018.

### I. Komunikime me sistemin GoAutoDial:

Thirrjet hyrëse	6,870
Thirrjet dalëse	102,455
Fushata komunikuese	49
Komunikimi ne Live Chat	4,981
Emaile me problematika	66

➤ Live-chat, analitike problematikat.

PYETJE	L/Pagesa dhe sigurime	Librat dhe Balance	TVSH	T Fitimi	T/B	Fatura	Falja, gjoba	Regjistrim	Inf/nga web	Kasat	Marr-me bankat
4,981	713	306	491	291	295	535	151	591	567	580	461

➤ E-mail,problematikat

1- Funksionimi i sistemit

2- Legjislacioni Tatimor dhe ndryshimet e tij

### II. Fushata informuese 49 sipas tematikës: (subjekte te informuara 102,455)

#### II.1 Detyrime të pa paguara


T.V.SH	14 (23,648)
Sigurime	10 (37,699)
Tatim në burim	8 (4,486)
Tatim Thjeshtuar Fitimi	1 (1,435)
Taksa kombëtare	6 ( 45)
Debitorë të ndryshëm	2 (6,431)

#### II.2 Përmbushje vullnetare

Mostransmetues kase	5 (18,283)
Përditësim të dhënash	1 (4,645)
Status pasiv	1 ( 76)
Sektori me Risk Bar kafe	1 (5,707)

Të dhëna përbledhëse për të gjitha llojet e fushatave dhe llojit të tatimeve

Nr	LLOJI I FUSHATËS	Nr. TMP sipas listes	Pesha specifike në %
1	TVSH	23,648	23.08%
2	SIGURIME	37,699	36.80%
3	TATIM NE BURIM	5,705	5.57%
4	TË TJERA	35,401	34.55%
	TOTALI	102,455	100.00%



II- Shtimin e treguesve të performancës për Qendrën e Thirrjeve dhe rritjen e besueshmërisë së rolit të saj Brenda dhe jashtë Administratës Tatimore

II.1 Maturimi për herë të parë të efektit në mbledhjen e të ardhurave nga telefonatat e realizuara.

Nr	FUSHATA	NR.TMP	VLERA DETYRIMIT	NR.TMP KONTAKTUAR				Qe kane paguar pas tel		VLERA ARKETUAR		% MBI TOTALIN	% MBI DET
				Telef	Detyrimi	Kontakt	Detyrimi	T.Pagues	Detyrimi	Leke	Euro		
I	TOTAL 30	72,279	18,275,259,952	64,009	16,296,760,138	33,287	8,047,675,341	7,731	2,203,351,243	1,695,998,154	13,818,618	9.28%	76.97%

DRT	Lista e ardhur nga DPT		Lista e tatimpagueseve		Tatimpagues te kontaktuar		I Jane pergjigjur telefonates duke paguar			Shuma Euro
	T.P	Detyrimi	Telefonuar	Detyrimi	Kontaktuar	Detyrimi	T.P	Detyrimi	Shuma paguar	
DRT Berat	1,450	326,681,853	1,286	287,708,427	671	110,574,990	169	41,453,796	39,181,868	401,581
DRT Dibër	1,026	347,497,113	888	300,893,075	445	151,019,426	109	60,857,685	50,104,805	405,985
DRT DTM	1,561	4,887,721,179	1,346	4,350,952,367	594	1,877,616,947	159	543,806,239	319,046,952	2,568,190
DRT Durrës	9,465	1,752,049,960	8,389	1,572,550,825	4,434	830,338,203	997	226,134,388	181,126,370	1,467,498
DRT Elbasan	2,861	534,022,944	2,534	486,856,579	1,304	261,659,328	322	84,527,736	62,820,515	509,118
DRT Fier	3,792	715,178,110	3,405	651,537,007	1,852	345,921,655	418	82,774,708	73,571,991	594,946
DRT Gjirokastrë	1,063	199,675,534	960	180,688,465	488	84,578,978	125	21,156,810	13,969,260	113,064
DRT Korçë	2,172	317,091,436	1,916	283,896,666	1,046	158,855,281	239	36,583,775	33,970,470	276,247
DRT Kukës	628	139,989,374	559	131,031,352	275	49,513,664	51	9,130,788	6,460,831	52,179
DRT Lezhë	2,603	432,243,516	2,291	364,021,453	1,141	175,497,306	253	31,633,404	25,812,344	208,473
DRT Sarandë	1,167	151,197,116	1,078	140,986,562	524	68,698,355	129	10,945,984	10,413,836	84,603
DRT Shkodër	3,502	633,603,021	3,240	603,162,711	1,597	274,698,724	491	69,178,704	56,033,521	454,678
DRT Tiranë	37,468	7,306,344,838	32,778	6,437,279,572	17,340	3,432,490,998	3,888	902,071,218	749,802,106	6,083,213
DRT Vlorë	3,521	531,963,958	3,339	505,195,077	1,576	226,211,486	381	83,096,008	73,683,285	598,843
Grand Total	72,279	18,275,259,952	64,009	16,296,760,138	33,287	8,047,675,341	7,731	2,203,351,243	1,695,998,154	13,818,618

## II.2 Maturimi për herë të parë të raportit para e mbledhur/ para të shpenzuar.

Raporti paraprak tregon se për rreth 1.7 Mld lekë të arkëtuara nga telefonatat për vitin 2019 janë shpenzuar për paga dhe shërbim telefonik 0.015 Mld lekë. *Ose për çdo 1.000 lekë të arkëtuar janë shpenzuar 8.8 Lek*

## II.3 Publikimi i aktiviteteve

Gjatë vitit 2019 janë realizuar 6 njoftime në Web për arritjet e Qendrës së Thirrjeve dhe 2 kronika televizive mbi aktivitetin e saj.

III-Organizimin e trajnimeve profesionale për rritjen e kapaciteteve në Drejtorinë e Qendrës së Thirrjeve

III.1 Pjesmarrje në 5 Trajnime profesionale nga AT (Gjithsej

III.2 Pjesmarrje në Workshop të organizuar nga IOTA, Krakov Poloni

III.3 Pjesmarrje në aktivitete TAIEK, Riga Letoni

## **PROBLEMATIKA**

Mos bashkëpunimi i vazhdueshëm midis Drejtorive

Kontakte të pa përditësuara të tatimpaguesve.

Mos kuptimi i rëndësisë së funksionit të Qendrës së Thirrjeve

Largimi nga objektivi kryesor i funksionit.

### **Objektivat dhe Aktivitet e parashikuara te realizohen per vitin 2020**

Thirrjet hyrëse	8,000
Thirrjet dalëse	120,000
Rritjen e numrit të fushatave të realizuara	50
Komunikimi ne Live Chat	6,000
Emaile me problematika	80

Përmirësim i standarteve të funksionimit

Përmirësim i treguesve të performances personale për çdo inspector

### **Kerkesat e Drejtorise per vitin 2020 ne funksion te realizimit te objektivave**

Sistemi Go Auto Dial duhet të përditësohet me versione të reja.

Të instalohen ndarjet e shërbimeve.

## IV. PERFORMANCA TEKNIKO-LIGJORE

Garantimi dhe zbatimi me paanshmëri i ligjit në mënyrë të tillë që çdo akt administrativ dhe dokument zyrtar që trajton Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, të jetë i mbështetur në Legjislacionin Tatimor dhe ligjet e tjera të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, është parim primar për vetë institucionin.

Nga Drejtoria Ligjore dhe Teknike janë trajtuar 1506 shkresa për të siguruar një informacion të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen vullnetare.

Janë publikuar:

- ☐ Rreth 30 njoftime lidhur me rritjen e ndërgjegjësimi publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri, në ndërfaqen e tatimeve (<https://ëëë.tatime.gov.al/c/8/45/lajme>) dhe rreth
- ☐ 52 materiale informuese në rubrikën "Tatimet këshillojnë".
- ☐ 4 buletine për të garantuar informimin e tatimpaguesve. Nga këto, 2 buletine kanë të bëjnë me vendimet e gjykatave për raste të lidhura me çështjet tatimore dhe 2 buletine teknike të administratës tatimore, që kanë të bëjnë me raste specifike dhe orientime për zbatimin e legjislacionit tatimor, të publikuara në ndërfaqen e tatimeve (<https://www.tatime.gov.al/c/8/129/133/vendime-gjyqsore-te-formes-se-prere>).

Në kuadër të garantimit të asistencës teknike dhe ligjore për Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe tatimpaguesit janë draftuar një sërë urdhëresash të brendshme, lidhur me unifikimin e praktikave tatimore dhe më konkretisht përmendim disa nga shkresat sqaruese:

- ☐ Për procedurën që duhet të ndjekin tatimpaguesit të cilët ushtrojnë veprimtari ekonomike në fushën e tregtimit të imputeve dhe makinave buqësore
- ☐ Për zbatimin sa më korrekt të VKM nr. 953, datë 29.12.2014 lidhur me zgjedhjen dhe aplikimin e TVSH-së në ndërtim.
- ☐ Për procedurat e regjistrimit të fitimit të pronësisë
- ☐ Mbi procedurat që duhet të ndjekin DRT lidhur me aplikimin e nenit 38 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar.

☐ Për Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe DRT lidhur me procedurën e mbajtjes së dosjes dhe dhënien e autorizimit për subjektet (tatimpagues) që përfitojnë nga përjashtimi i taksës së materialeve/artikujve plastikë/qelqi.

Janë trajtuar mbi 50 akte ligjore e nënligjore të përcjella nga MFE lidhur me legjislacionin tatimor dhe është dhënë opinion mbi to.

Janë propozuar ndryshime ligjore lidhur me: “Procedurat tatimore”; “Tatimit mbi të ardhurat”; “Tatimin mbi vlerën e shtuar”, “Taksat kombëtare”, “Për nënpunësin civil”, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nënpunësve publike”, “Lehtësirat fiskale në kuadër të gjendjes së fatkeqësisë natyrore”, është përgatitur “Projekt Ligji Për Shkëmbimin Automatik të llogarive Financiare” si dhe relacioni shoqërues, tabela e përputhshmërisë, raporti i vlerësimit të ndikimit (RIA) si dhe Draft VKM-ja që do të dali në zbatim të këtij ligji etj., një pjesë e konsiderueshme e të cilave janë marrë në konsideratë nga MFE.

Në kuadër të bashkëpunimit ndërinstitucional janë finalizuar:

☐ Marrëveshja e bashkëpunimit me Qendrën Kombëtare të Biznesit nr. 16124 prot, datë 28.08.2019

☐ Marrëveshja e bashkëpunimit me Agjencinë e Ofritit të Shërbimeve të Integruara (ADISA) nr. 6250 Prot, datë 25.03.2019

☐ Marrëveshja e bashkëpunimit me Autoritetin Kombëtar të Ushqimit nr. 13262 Prot, datë 08.07.2019

☐ Marrëveshja e bashkëpunimit me Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare nr. 18429 Prot, datë 04.10.2019

Drejtoria Ligjore dhe Teknike ka marrë masa në përmirësimin e përfaqësimit cilësor në konfliktet gjyqësore, përgatitjen e provave dhe prapësimeve etj. Administrata tatimore është përfaqësuar profesionalisht në 172 çështje të lidhura me marrëdhënie pune, nga të cilat në Gjykatën Civile janë gjykuar 119 konflikte gjyqësore me ish-punonjës të kontraktuar me kontratë punësimi dhe në Gjykatën Administrative ka patur në trajtim 53 konflikte gjyqësore me palë ish-nëpunës civilë të konfirmuar.

Lidhur me vendimet e Komiteteve rezulton se për vitin 2019 janë publikuar:

Komiteti i Përmbushjes:

☐ Vendim nr. 21, datë 21.02.2019

☐ Vendim nr. 22, datë 28.03.2019

**Komiteti i Reformave:**

☐ Vendim nr.10, datë 01.02.2019

☐ Vendim nr. 11, datë 14.02.2019

☐ Vendim nr. 12, datë 07.03.2019

☐ Vendim nr. 13, datë 24.06.2019

☐ Vendim nr. 14, datë 13.08.2019

☐ Vendim nr. 15, datë 12.09.2019

**Komiteti Operacional:**

☐ Vendim nr.14, datë 21.01.2019

☐ Vendim nr. 15, datë 10.05.2019

## V. KONTROLI TATIMOR

Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT-ë, bazuar në objektivat Strategjike të hartuara dhe miratuar, punoi dhe realizoi detyrat e ngarkuara në funksion të rritjes së performacës së administratës tatimore për mbledhjen dhe realizimin e të ardhurave buxhetore.

Drejtoria e Kontrollit Tatimor në DPT ka funksion kontrollin e performancës së realizimit të detyrave nga Drejtoritë e Kontrollit në DRT dhe ofrimi i asistencës së duhur profesionale dhe analiza e dhënave statistikore të situatës së kontrolleve.

Objektivi kryesor i Drejtorisë së Kontrollit në DPT është udhëheqja metodologjike e funksionimit të kontrollit tatimor dhe monitorimi i punës së drejtorive tatimore rajonale.

Realizimet e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, bazuar në Rregulloren e Brëndshme të Administratës Tatimore, në kërkesat e Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në RSH”, i ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrit të Financave në zbatim të tij, në zbatim të objektivave të Planit Strategjik 2017-2021, si dhe në ndjekje të rekomandimeve të FMN-së.

- ✓ Detyrat funksionale të drejtorisë së kontrollit janë si më poshte dhe janë realizuar në përputhje me objektivat e miratuar në planin operacional për vitin 2019:
- ✓ Kryen kontrolle dhe bën verifikime në bazë të planit vjetor në drejtoritë rajonale për të verifikuar nëse funksionet e kontrollit në këto drejtori kryhen në përputhje me procedurat e përcaktuara në Legjislacionin fiskal dhe që janë pjesë e këtij Manuali.
- ✓ Raporton gjetjet që kanë dalë gjatë kontrolleve në lidhje me metodologjinë e kontrollit tek tatimpaguesit, mospërmbushjet apo shkeljet ligjore, ose shërbimet e ofruara për tatimpaguesin, së bashku me rekomandimet për ndryshime të mëtejshme, duke propozuar edhe masa në rastet e shkeljeve administrative e ligjore. Dhe duke analizuar problematikat e konstatuara dhe mangësitë e inspektoreve të kontrollit ai rekomandon programet e trajnimit, për rritjen e aftësive të inspektorëve.
- ✓ Monitoron arritjet e drejtorive tatimore rajonale kundrejt planeve të dërguara për zbatim nga DPT, investigon ndryshimet nga plani i kontrollit, bën komente për çdo shmangie të dukshme në masat e marra në kontroll nga ato të planifikuara dhe merr masa për të korrigjuar këto shmangie, kur është e nevojshme. Gjithashtu ofron këshillim dhe udhëzim të specializuar për një kontroll eficient dhe efektiv të tatimpaguesit.

## **I. Përzgjedhja për Kontroll**

Në zbatim të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, neni 80, Kontrolli Tatimor, është hartuar dhe Manuali I Kontrollit Tatimor, sipas të cilit përcaktohet dhe përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll dhe plani mujor i tyre.

Përzgjedhja e tatimpaguesve për kontroll hartohet nga Drejtoria e Menaxhimit të Riksit pasi ka bërë seleksionimin e tatimpaguesve të cilët rezultojnë me risk sipas modulit të Riskut.

## **II. Objektivat për vitin 2019**

Objektivate drejtorisë së kontrollit Tatimor janë pjesë e tre objektivave kryesore të planit strategjik 2017-2021. Bazuar në objektivat strategjike përkatësisht për drejtorinë e kontrollit objektivat dhe aktivitete konkrete të ndërmarra për vitin 2019 janë si më poshtë:

### **Objektivi 1: *Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.***

**Nënobjektivi 1.2:** Rritja e ndërgjegjësimit publik duke ndihmuar në zhvillimin e kulturës për përmbushje vullnetare më të lartë dhe kuptimin e rolit të Administratës Tatimore në shoqëri

**Aktiviteti:** Të përgatitet dhe të përditësohet në mënyrë të vazhdueshme një seri pyetje dhe përgjigje për publikim në faqen e internetit "

- ✓ Njoftime që lidhen me ceshtje kontrolli si dorezimi I pasqyrave financiare, vendime ortakesh, dorezim inventari etj
- ✓ Hartimi i një relacioni përmbledhës me gjetjet kryesore.

### **Objektivi 2: *Implementimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor***

**Nënobjektivi 2.1:** Zbatimi i strategjisë së përmbushjes së menaxhimit të riskut.

**Aktiviteti:** Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve. "

- ✓ Ndjekja e planeve për kontrollet sektoriale, për tatimpaguesit të cilës nuk reagojnë pozitivisht (nese do realizohen nga Drejtoria e Menaxhimit të Riskut)
- ✓ Dërgimi i planeve të kontrollit DRT-ve për zbatim
- ✓ Analizmi i rezultateve"

**Nënobjektivi 2.2:** Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore.

**Aktiviteti 1:** Kontroll tatimor i përqendruar tek tatimpaguesit, risqet dhe sektorët ekonomikë të cilët kanë gjeneruar humbje të konsiderueshme në buxhetin e shtetit

- ✓ Hartimi dhe zbatimi i opinioneve metodologjike të perditesuara dhe në vazhdimësi për zbatimin uniform të procedurave teknike të kryerjes së kontrollit tatimor në tatimpaguesit "Rekomandim I Misionit të FMN
- ✓ Të bëhet analizë e rolit dhe rezultateve të funksionit të kontrollit nga zyra për t'i përmirësuar rezultatet e kontrolleve dhe për të eliminuar punën me pak vlerë." "Rekomandim I Misionit të FMN
- ✓ Të bëhet analizë për të kuptuar arsyet për shkallën e ulët të vjeljes së vlerësimeve tatimore nga zbulimet e kontrollit tatimor dhe të përgatiten përgjigjet e duhura."

**Aktiviteti 2:** Zhvillimi i metodave të reja të analizimit të të dhënave në mënyrë elektronike, gjatë kontrollit tatimor      Përgatitje e udhëzimeve apo rregulloreve që do ndihmojnë në procesin e kontrollit tatimor gjatë implementimit të transaksioneve elektronike

- ✓ Zhvillimi i kapacitetit për monitorimin dhe kontrollin e transaksioneve elektronike.
- ✓ Parashikimi i trajnimeve apo marrja e njohurive nga inspektorët e kontrollit mbi zbatimin e transaksioneve elektronike

**Aktiviteti 3:** Përdorimi i qasjes për parandalimin e mashtrimeve tatimore mbështetur në monitorimin dhe komunikimin e vazhdueshëm me tatimpaguesit, në mënyrë që të stimulojnë korrigjimin vullnetar dhe në kohë të sjelljes jo të rregullt;

- ✓ Programi i kontrollit në DRT, lidhur me funksionimin e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor dhe përmbushjen e kontrollit tatimor në tatimpaguesit e përzgjedhur për kontroll, për periudhat e pakontrolluara dhe detyrat e lëna për zbatim nga kontrollet e mëpareshme.
- ✓ Grumbullimi i deklarimeve të tatimpaguesve persona të lidhur për transaksionet e tyre, sipas Formularit të Udhëzimit të Ministrit të Financave. Bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale Tatimore (Drejtorinë e Kontrollit Tatimor) në lidhje me evidentimin e tatimpaguesve mosraportues.
- ✓ Njoftimi i tyre për raportimin e të dhënave dhe vendosja e penalteteve ligjore për mosraportim brenda afatit ligjor."

- ✓ Azhornimi i bazës së të dhënave për transaksioneve ndërmjet palëve të lidhura për përdorim afat-gjatë për qëllimet e trajtimit të tatimpaguesve të lidhur që paraqesin me rrezik.
- ✓ Azhornimi i dosjeve të tatimpaguesve të gjykuar me risk për të cilët është kërkuar dokumentacion i transferimit të çmimit.
- ✓ Analiza e riskut për këto tatimpagues të përzgjedhur."
- ✓ Asistimi i DRT Tatimpaguesit e Mëdhenj dhe D.R.T. Tiranë për trajtimin e rasteve të transferimit të çmimit dhe strukturen e propozuar nga FMN për bashkim të sektorit.

**Aktiviteti 4:** Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve. Përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarte të tyre "

- ✓ Analizimi i propozimeve nga DRT-të në lidhje me 30% të planit për kontrollet tatimore
- ✓ Analizimi i të dhënave dhe miratimi i tatimpaguesve për kontroll mujor
- ✓ Analiza e gjetjeve dhe rezultateve të raporteve të kontrollit tatimor dhe nxjerrje e rekomandimeve për përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së kontrollit
- ✓ Përmirësimi i cilësisë së kontrolleve. Përditësimi i procedurave të kontrollit për të siguruar kryerjen në kohë dhe në mënyrë standarde të tyre;"

### **Objektivi 3: *Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore***

**Nënobjektivi 3.2:** Zhvillimi i kapaciteteve dhe motivimi i punonjësve

**Aktiviteti:** Zbatimi i programeve të trajnimit si për drejtuesit e sapo caktuar ashtu edhe për ata me përvojë.

- ✓ Vlerësimi i efikasitetit dhe efektivitetit të trajnimeve të zhvihuara.
- ✓ Propozime për trajnime sipas moduleve të Kontrollit për drejtorin, përgjegjësit e sektorëve dhe inspektorët e Drejtorisë së Kontrollit.

### **III. Aktivitete të realizuara për vitin 2019 dhe problematikat**

**Aktivitetet e realizuara në zbatim të objektivave strategjike.**

- ✓ 137 inspektorë janë trajnuar për zbatimin e manualit të ri për Kontrollin nga Zyra (lidhet me objektivin 3)

- ✓ Hartimi I njoftimeve për pagesën e kësteve të Tatimit mbi Fitimin si dhe për dorëzimin brenda datës 31 Mars 2019 deklaratën e pagesës së tatim fitimit dhe pasqyrat financiare për vitin fiskal 2018 <https://www.tatime.gov.al/c/8/45/lajme/> (lidhet me Objektivin 1)
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i opinioneve metodologjike të përditësuara dhe në vazhdimësi për zbatimin uniform të procedurave teknike të kryerjes së kontrollit tatimor në tatimpaguesit (lidhet me objektivin 2):
  - Nr. 3378 Prot Datë 13.02.2019 "Për Vlerësimin e detyrimeve tatimore për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndëtesore dhe TAP, nga plotesimi i pasakte i kategorise "PF te vetepunesuar te vetem, profesione te lira, pensionist"
  - Nr. 3381 Prot Date 13.02.2019 "Per kalimin ne pergjegjesi te tatimit mbi fitimin dhe sistemimet e deklarates se tatimit te thjeshtuar te fitimit per vitin 2018"
  - Nr. 23177/1 Prot Date 09.04.2019 " Procedurat Standarte mbi zbatimin e rregullave per pasqyrimin e veprimeve ne sistemin C@TS nga inspektori i kontrollit"
  - Nr. 17.04.2019 " Per zbatimin e afateve te perfundimit te akteve te kontrolleve tatimore"
  - DRT duhet të kryejne Raportime javore pjesë të performances mujore (lidhet me Objektivin 2, Nenobjekti 2.1).

#### ***Zbatimi I Rekomandimeve të Misionit të FMN (lidhet me Objektivin 2, nenobjekti 2.2)***

- ✓ Të bëhet analizë e rolit dhe rezultateve të funksionit të kontrollit nga zyra për t'i përmirësuar rezultatet e kontrolleve dhe për të eliminuar punën me pak vlerë.
  - Janë identifikuar detyrat që nuk duhet të realizohen nga kontrolli nga zyra por nga struktura të tjera si psh. Shërbimi i Tatimpaguesve etj, të dala nga seancat e trajnimit
  - Eshtë analizuar ngarkesa e cdo inspektori për të bërë një shpërndarje më optimale midis kontrollit nga zyra dhe kontrollit në vend
  - Analizimi i faktorëve që çojnë në ulje të të ardhurave (analizë sektoriale apo ne nivel NIFT) dhe sinjalizimi i strukturave të tjera brenda Drejtorisë Rajonale për të ndërmarrë veprimet e mundshme
- ✓ Të bëhet analizë për të kuptuar arsyet për shkallën e ulët të vjeljes së vlerësimeve tatimore nga zbulimet e kontrollit tatimor dhe të përgatiten përgjigjet e duhura.
  - Niveli i arkëtimeve për vitin 2019 rezulton në masën 70%. Ndërkohë të gjitha detyrimet e mbetura të paarkëtuara, duke hequr rastet në apel apo gjykatë kanë kaluar në Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë për të vazhduar me procedurat përkatese me synim arkëtimin e të gjitha detyrimeve.

- Duke parë rendësinë e arkëtimeve ndaj detyrimeve të nxjerra nga aktet e kontrollit, është vendosur si KPI, kriter performance për çdo inspektor kontrolli, i cili do vlerësohet mbi baza vjetore.

## VI. MENAXHIMI I RISKUT

Drejtoria e Menaxhimit të Riskut në organigramën e DPT është në varesë të Drejtorisë së Hartimit të Programeve dhe drejtohet nga Drejtori i Drejtorisë së DMR edhe organizuar në 2 sektore

- Sektori I Analizës së Riskut -me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialiste (1 pozicion vakant)
- Sektori I Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Risqeve -me 1 Përgjegjës dhe 6 Specialiste (1 pozicion vakant)

Objektivi parësor i modelit të riskut që ushtron veprimtarinë DMR është identifikimi mbi bazën e kritereve të miratuara dhe zhvilluara paraprakisht i tatimpaguesve që përbëjnë risk potencial lidhur me përmbushjen, veprimtaria tregtare e të cilëve do të verifikohet dhe trajtohet nga ana e administratës tatimore në harmoni me procedurat ligjore në fuqi.

### 1. Objektivat e Drejtorisë për vitin 2019

Objektivi Strategjik i DMR është përmirësimi i analizës dhe vlerësimit të rreziqeve të rëndësishme të mosrespektimit të legjislacionit tatimor që ka një ndikim në uljen e hendekut të mospërmbushjes.

Ky objektivi bazohet në këto shtylla të rëndësishme:

- Zhvillimi dhe zbatimi i projekteve sektoriale të përmbushjes dhe reduktimi i nivelit të riskut
- Zgjerimi i kapaciteteve për të ekzaminuar të dhënat nga burime të ndryshme gjatë analizës së riskut të përmbushjes së tatimeve;
- Përdorimi i burimeve të informacionit nga palë të treta (Dogana, Banka, DPSHTRR etj); dhe sigurimi që çdo informacion të jetë i integruar në modelin e kontrollit duke u bërë një faktor për vlerësimin e rrezikut
- Monitorimi i rregullt i niveleve të përmbushjes.
- Forcimi i kapaciteteve dhe bashkëpunimi i pandërprerë me bizneset duke synuar marrjen e një baze të plotë të dhënash

Tregues kryesorë të performancës janë:

- Madhësia e hendekut tatimor sipas llojeve të risqeve
- Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i numrit të tatimpaguesve me risk.

- Zvogëlimi i riskut të sjelljes së tatimpaguesve, pas trajtimit – reduktimi i demit.
- Vleradhe numri i deklaratave të korrigjuara nga tatimpaguesit, si rezultat i njoftimeve të dërguara apo takimeve të mbajtura me ta.

Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT

Objektivat e DMR janë në përputhje me vlerësimin e TADAT Gusht 2016, Kapitulli III Vlerësimi I performances se të ardhurave tatimore ,POA 2 - POA 6

## **2. Aktivitet e programuara dhe realizuar gjatë vitit 2019 në funksion të realizimit të objektivave.**

### **1.Planet sektoriale të realizuara gjatë vitit 2019**

#### **1.1 Planit sektorial i Bar-Restoranteve**

Zbatimi i Planit operacional të Bar-Restoranteve si dhe implementimi, monitorimi dhe analizimi I rezultateve të planit. Gjatë hartimit të planit operacional u përdor si material referues materiali I lënë nga ekspertët I FMN-se. U ndanë tatimpagueit : 1) me risk të ulët 2) me risk të mesëm, 3) me risk të lartë. Rankimi I tatimpaguesve u krye duke marrë në shqyrtim 10 rregulla të riskut si më poshtë:

1. - Blerjet e deklaruara nga Ju janë tepër të larta në raport me shitjet e deklaruara;
2. - Niveli i deklaruar nga Ju i pagave të punonjësve, është ndjeshëm nën nivelin mesatar të tregut dhe në kufirin e pagës minimale;
3. - Numri i punonjësve të deklaruar nga Ju është i ulët në raport me aktivitetin e kryer;
4. - Vlerë e ulët e kuponit mesatar;
5. - Paga mesatare e deklaruar nga Ju për pozicionet e punës: kuzhinier; kryekamari; pastičier është ndjeshëm nën nivelin mesatar të tregut;
6. - Tendencë për të shmangur detyrimet duke ndryshuar NIPT-in;
7. -Qarkullimi i deklaruar në kasën fiskale është më i lartë se qarkullimi i deklaruar në deklaratatën eTVSH-së;
8. - Rënie e ndjeshme në qarkullimin e deklaruar, krahasuar kjo me periudhat paraardhëse
9. -Kontributet dhe tatimi në burim të deklaruara nga Ju në deklaratat respektive, janë më të larta se shpenzimet tatimore në deklaratën e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin 2018;
10. -Qarkullimi i raportuar nga Ju, afër pragut minimal të regjistrimit për TVSH-në ,për të mos ndryshuar përgjegjësinë tatimore që ju takon.

Nga kjo ndarje u përcaktuan 11,543 tatimpagues me risk të ulët 400 tatimpagues me risk të mesëm dhe 100 tatimpagues me risk të lartë.

- Jane hartuar letra te personalizuar per tatimpaguesit e identifikuar me risk te ulet ne popullaten e Bar-Restoranteve.
- U perpiluan dhe u derguan 11,543 letra te ndara sipas DRT-ve perkatese.
- Pergatija e materialeve te trajnimit per personat pergjegjes per kryerjen e vezhgimeve dhe intervistave. Material trajnues ne word dhe prezantim per inspektoret e perfshire ne process.
- Hartimi I formatit te vezhgimit me pyetjet qe do plotesoheshin gjate kryerjes se vezhgimit nga ana e inspektoreve per cdo tatimpagues te vezhguar. Per kryerjen e vezhgimeve nga ana e DRT-ve eshte raportuar ne cdo jave ne lidhje me planifikimin e tyre dhe realizimin gjate javes.
- Takim me perfaqesues te subjekteve ne nivel lokal dhe me shoqaten e kontabilisteve.
- Pergatitja e formatit te raportimit per secilen strukture te perfshire ne planin operacional duke filluar me DSHT-te por dhe me drejtorite e kontrollit neper DRT.
- Percjellja e nje mesazhi sensibilizues per 20 tatimpaguesit me numrin me te larte te punonjesve. Ne bashkepunim me Akshin u dergua nje mesazh sensibilizues per te gjithë punonjesit e Administrates Shteterore mbi rendesine e terheqjes se kuponit tatimor si konsumatore te mundshem fundore.
- Takim ne DRT- Tirane me ofruesit e programe software per Bar-Restorante. U ftuan ne takim perfaqesues nga 12 kompani te ofrimit te sherbimit ne menyre qe te krijohej mundesia e heqjes se mundesise se printimit nga programet e tyre te faturave jo-fiskale.
- Analize e gjendjes se statusit te tatimpaguesve ne vijim te projektit. U zhvillua analize e statusit te tatimpaguesve per te verifikuar cilet tatimpagues vazhdonin te ishin active dhe cilet mund te kishin kaluar ne pasive ose kerkese per crregjistrim.
- Perpilimi I intervistes dhe raporteve te intervistes se kryer me tatimpaguesit me risk te mesem. U perpilua formati I intervistes qe duhej ndjekur ne intervistat me tatimpaguesit me risk te mesem. Ne bashklidhje me intervistat u hartua nje raport I shkurter per inspektoret per menyren si shkoi intervista dhe si ne opinionin e tyre u pergjigjen tatimpaguesit. Gjithashtu u hartua nje pyetesor I shkurter per tatimpaguesit per te vleresuar ne nje fare menyre dhe sjelljen e inspektoreve.
- Dergimi informacioni ne DRT per 500 tatimpaguesit te identifikuar me risk te mesem dhe te ulet ne lidhje me vetdeklarimet e tyre. Per 500 tatimpagues u mblodhen dhe u analizuan te dhena nga vetdeklarimet ne sistemin cats duke u krijuar ne kete menyre profile risku per keto tatimpagues me te dhena nga viti 2016, 2017,2018,2019.

- Analize kase per subjektet te cileve u eshte derguar leter dhe populates ne teresi.(perfshire analizen per te tre grupet te identifikuar me risk te ulet, te mesem, te larte) analize ne kase per subjektet me risku te ulet duke filluar nga muaji qershor me frekuence mujore, ne menyre qe te shihej trendi I deklarimit te ketyre subjekteve dhe numri I kuponave te leshuara vlera e kuponit mesatar.
- Analise Tvsh-je per popullaten e Bar-Restoranteve dhe ne vecanti te subjekteve qe kane marre leter, kane kryer intervista, jane lajmeruar per kontroll. Analize tvsh-je me baze tre mujore mq shume tatimpagues kane deklarime tre mujore ne menyre qe te verifikoheshin rezultatet ne qarkullimin me tvsh, shitjet me 20% si dhe shitjet me 6%.
- Analize e numrit te punonjesve dhe ndryshimet e mundshme ne te tre kategorite e tatimpaguesve. Analize e listpagesave te tatimpaguesve te identifikuar me risk per sektorin
- Analize e kontrolleve te Bar-Restorante per te identifikuar nese jane verifikuar kriteret e riskut te identifikuar nga ana e DMR-se.

## **1.2 Plani sektorial ne informalitetin ne tregun e punes**

Ne kuader te luftes ndaj informalitetit ne tregun e punes u analizuan te dhenat e listepagesave Qershor/2019 si periudha e fundit e mbyllur ne afate ligjore e popullates se tatimpaguesve.

Ne analize u moren:

1. Pozicionet e punes ku eshte punuar mbi 20 dite pune
2. 3 kategori te kontributeve
  - I punësuar i larguar nga puna (shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës) pavarësisht nga data e shkëputjes dhe orët e punuara gjatë muajit, subjekti punëdhënës deklaron.
  - I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më pak se 87 orë në muaj, subjekti punëdhënës deklaron.
  - I punësuar për herë të parë apo rishtazi te subjekti përkatës pavarësisht nga data e fillimit dhe orët e punuara gjatë muajit, subjekti punëdhënës deklaron.
3. LLojet e biznesit BM,BV ME TVSH dhe BV
4. Pozicionet e punes me paga te deklaruar nga 1-30.000 leke/muaj te cilat vleresohen si te nendeklaruara.

Ne total u evidentuan 316 profesione te ndryshme me paga te cilat vleresohen te nendeklaruara.

Ne total jane evidentuar 19.446 pozicione pune ne keto profesione qe vleresohen te nenpaguar.

U derguan ndaj punemarreseve 19.229 letra te personalizuar dhe gjithashtu ndaj 11.942 tatimpaguesve ne te cilet keto punemarres jane te punesuar.

Rezultatet e planit jane inkurajuese dhe mbeshtesin vendimin per vazhdimin edhe gjate vitit 2020 te ketij plani duke marre ne konsiderate profesione te tjera.

## **2.Hartimi i kriterëve të reja të riskut lidhur me analiza specifike**

### **2.1 Kriteret e reja për Manualin e Hetimit Tatimor**

Ne Manualin e ri të Hetimit Tatimor ,është përfshirë një seri e re prej 13 kriteresh risku që së bashku me 10 kriteret që ekzekutohen nga Moduli I Riskut përbejnë bazën e vlerësimit të Tatimpaguesve që do verifikohen.Mbi keto kritere risku hartohen periodikisht lista e popullatës së tatimpaguesve që të paktën rezultojnë me një rregull të thyer e cila i dërgohet për verifikim strukturave të hetimit tatimor. Me poshtë kriteret e reja:

1. Qarkullimi me kase më e madhe se të ardhurat e deklaruara në deklaratën vjetore të Tatimit /Tatim mbi Fitimin e Thjeshtuar.
2. Xhiro/Kupona Shtator-Dhjetor 2015 krahasuar me të njëjtat periudha 2016-2018 – Rënie e Xhiros/Kupona duke krahasuar periudha të caktuara kohore.
3. Transmetime < 20 dite. Subjekti regjistruar minimalisht një muaj më parë.
4. Punonjës  $\leq X$  Sipas aktiviteteve të caktuara (psh. për sektorin bar min 3 restorante min 6, furra buke 4 ). Vlerësim edhe sipas vendndodhjes gjeografike.
5. Qëndron mbi 1 Muaj në statusin e kontributeve të pikes së pare dhe mbi 6 muaj për piken 2:
  - I punësuar për herë të parë apo rishtazi të subjekti përkatës pavarësisht nga data e fillimit dhe orët e punuara gjatë muajit, subjekti punëdhënës deklaron Person në periudhën e kursit të formimit profesional, apo dhe programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë, të miratuara dhe me financim nga zyra përkatëse e punësimit të detyrimit të kontributeve vetëm për degën e aksidenteve në punë.
6. Raporti Paga/Shpenzime Total > X% (X=mesatarja sektorit. Psh. bar/restorante 40%).
7. Qarkullimi i deklaruar nga tatimpaguesi është më e vogël se totali i shpenzimeve fikse.(Paga Bruto+Kontribute Punemarres+Qera+ etj.
8. Tatimpagues me status Pasiv ,Cregjistruar ose Kerkese për cregjistrim rezultojnë të kenë deklaruar Xhiro/Kopona nepermjet paisjeve fiskale.
9. Vlerë e lartë e Importeve ose Exporteve por numër i vogël punonjësish të deklaruar.
10. Tatimpagues që i afrohen pragut të ndryshimit të përgjegjësisë (>95%) por nuk e kalojnë atë.

11. Tatimpagues qe rezultojne me gjoba per mosleshim te kuponit tatimor ose mosdeklarim te punonjesve.
12. Subjekte qe rezultojne me qarkullim nen pragun qe ndikon ne ndryshimin e pergjegjesive tatimore por nga ana tjeter rezultojne me blerje me te medha se ky prag
13. Random Check i NIPT-eve pasiv ose çregjistruar, për të verifikuar lidhjen me subjektin e hapur ne te njëjtën vendodhje ose me te njejtin administrator/pronar (kryesisht subjekte qe nuk kane kaluar 8 Mln ose kane gjoba.

## **2.2 Kriteret qe aplikohen per kontroll nga DRT-të (pjesa prej 30%)**

Në mënyrë që të kemi një formalizim të arsyeve të përzgjedhjes për kontroll të tatimpaguesve nga DRT-te jane aplikuar 8 kriteret perzgjdhe të cilat në vetvete kanë pikëzime të ndryshme për fasha të ndryshme. Kriteret që perfshihen në këtë analizë risku janë:

1. Koha pa u ushtruar kontroll ndaj tatimpaguesit.
2. Xhiro e 3 viteve të fundit të marra së bashku ndarë sipas fashave.
3. Numri I punonjësve me pagë minimale - % ndaj totalit të punonjësve në listëpagesën e muajit të fundit të deklaruar
4. Rënie e pagesës së Tatim Fitimit- krahasimi periudhave te fundit kur xhiro ka rritje
5. Humbje tatimore gjatë 5 viteve të fundit
6. Renie e pageses se TVSh-se nga krahasimi 12 periudha të fundit me paraardhëset në rastet kur nuk ka investime domethënëse (mbi 10% të blerjeve)
7. Gjëndje kreditore e TVSh-së (ndër 100 me te mëdhatë e DRT-së, nga më i madhi e në zbritje), kur Tatimpaguesi nuk është eksportues domethënës ose në fazë investimi
8. Rritje e zërit Derdhje nga Ortakët në Bilancin e shoqerisë të 3 viteve të fundit

## **2.3 Permiresimi I Modulit te e Riskut**

Rregullat e modulit të riskut janë në proces të vazhdueshëm përmirësimi pasi ndikohen drejtperdrejte nga ndryshimet në paketat fiskale, nga sjellja e tatimpaguesve si dhe nga dinamika e mjedisit ekonomik. Ne kuadër të përmirësimit të funksionalitetit të rregullave, pas testimeve të vazhdueshme për evidentimin e problematikave të tyre, DMR ka bërë ndryshimet e nevojshme në logjikë si dhe ne përditësimin e dokumentit në word.

Ne bashkepunim me specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit për të siguruar mbarëvajtjen e modelit, zhvillimet e reja dhe përditësimin jane analizuar te gjitha të

dhënat nga Modeli i Riskut si dhe informacione të tjera dhe identifikon sjellje dhe trende të reja të sjelljes së tatimpaguesve.

Jane kryer ekzekutimin e modelit të riskut për projektet sektoriale, për rimbursimin e TVSH-së apo nevoja të tjera analizash.

Gjate periudhes Qershor – Dhjetor jane hapur rreth 30 Jira ne sistem, dhe jane rreth 130 korrespondenca me palen mirembajtese gjate kesaj periudhe kohe per te trajtuar problematikat qe jane evidentuar dhe per te bere permiresimet e nevojshme.

## **Maj 2019**

U testuan ne ambientin Live 50 rregullat e Modulit te Riskut. Nga testimet rezultoi se per nje pjese te rregullave mungonte mesatarja sektoriale ndersa per te tjerat u hasen problematikat si me poshte te cilat u trajtuan ne muajt ne vijim.

Testimi i Rregullave- problematikat qe kemi hasur gjate testimit:

### **1. TPLTO**

Kushtet e rregullit funksionojne

TLS problem ne llogaritje pasi nuk identifikojme dot ku merret nga skripti 'Company Vat paid'.

Ndryshimi I deklarates se Tvsh-se sjell problem me pagesen reale.

### **2. VAT REF1S**

Kushtet e rregullit dhe TLS funksionojne, por duhet pare rasti kur totali I shitjeve dhe totali I blerjeve jane zero, duhen hequr nga lista pasi dalin te rregull I thyer nderkohe qe nuk jane.

4. VAT IMPORT dhe VAT EXPORT u vu re se rregulli thyhet por nuk ka shmangie tatimore pasi fatura mund te deklarohet muajin pasardhes dhe sistemi cats e lejon kete. Propozohet se si ne rastin e faturave te shitjeve qe sistemi nuk e lejon deklarimin ne muajin pasardhes.

5. IOCIT – llogjika e rregullit ne word eshte ndryshe nga skripti, ne script nuk merren Shitje/Blerje te perjashtuara dhe Shitje/ Blerje pa Tvsh gjithashtu ne script merret borxhi I keq.

6. CITPL/ PITPL - rregulli funksionon, te TLS merret humbja e fundit. Duhet pare si eshte shkruar skripti per subjekte qe ndryshojne pergjegjesine tatimore ne mes te vitit.

7. CITINC - rregulli funksionon, por ne word nuk eshte autongarkesa ndersa ne script eshte.

8. PITINC – rregulli funksionon por TLS ndryshe nga word ku TLS eshte prodhim I differences me pit rate, ne script tls eshte prodhim I vleres se tatueshme ne shitje me normen 15%.  
Pse 15%? Pse jo diferenca?

9. TPAMD VAT – kushtet e rregullit funksionojne por nuk na perputhet TLS, perputhet vetem per niptin e pare, duhet pare skripti.

10. TPAMD CIT – nuk funksionon si rregull, na jep tatimpagues qe nuk i plotesojne kushtet per te qene rregull I thyer.

11. TPLRS - kushti ne word eshte per subjekte qe deklarojne tvsh nga 7 deri ne 30 dite me vonese, ndersa ne script eshte vetem 1 dite me vonese, gjithashtu nuk percaktojme dot t/s pasi nuk identifikojme ku eshte marre shuma e pageses se tvsh nga kontabiliteti. Duhet pare skripti.

12. LF PIT – te kushti ne script vonesa 1 dite jo 7 deri ne 30 sic eshte ne word, t/s ne rastin kur kemi vleresim automatik per disa raste llogaritet e njejte ne vlere 27,083, dhe jo det pit/12 si ne rastet e tj.

13. LF CIT - te kushti ne script vonesa 1 dite jo 7 deri ne 30 sic eshte ne word, t/s eshte ne rregull.

Keto problematika u diskutuan ne mbledhjen e zhvilluar ne date 20/05/2019 me perfaqesuesit e pales se mirembajtjese.

## **Qershor 2019**

U testuan Rregullat e Riskut: TPLTOA, TPLTOB, TCSALA, EXRTC, IOCITB, IOCITA, IOCIT, TCTPR dhe u raportuan rezultatet në Jira.

U identifikuan dhe u rregulluan problematikat në lidhje me Rregullat e Riskut: PRDEC, PRDECB.

U krijuan Jira-t e reja dhe u vazhdua analiza për Rregullat e Riskut: VAT REF 1S, VAT Import & VAT Export, TPLRS, LF PIT, LF CIT.

U testuan Rregullat e Riskut: IOCIT, CITPL/ PITPL, CITNC, PITINC, TPAMD VAT.

U raportuan në Jira rastet problematike për Rregullin e Riskut TPAMD CIT.

Pas ekzekutimit te paketës EXRTC te përfunduar me sukses në Live u bene ritestime te rregullit te cilat rezultuan te sukseshme.

U testuan rregullat si me poshte: TCSAL, TCSALA, TCSALB, TCTPR.

Rezultoi se per rregullat lidhur me Pagat (TCSAL, TCSALA, TCSALB) kushtet plotesohen ndersa vlere e Tax Loss Score nuk perputhet si dhe per rregullin TCSAL rezulton TLS negative.

Ndersa per rregullin TCTPR na rezultojne me problematik si kushtet ashtu dhe TLS.

U be ri- testimi i rregullave TPLTOA, TPLTOB dhe TCTPR per nipte perkatese ku na rezultojne mosperputhje te Kushteve dhe te Tax Loss Score.

U identifikuan dhe u dërguan në Jira rastet të cilat kanë nevojë për analizë të detajuar nga ikubINFO në lidhje me rregullin e riskut VATREF1S (SLA2-74).

U ri-testuan rregullat TPAMD VAT & TPAMD CIT për të cilat rezultuan mosperputhje të TLS.

U rritestuan rregullat PITINC/CITINC për të cilat rezultuan mosperputhje të TLS dhe në disa raste mosplotësim të kushteve.

## **Korrik 2019**

Sipas manualit të Drejtorisë së Menaxhimit të Riskut u bë me dt.19/07/2019 ekzekutimi i Modullit të Riskut për të përgatitur Planin e kontrollit për periudhën Korrik-Dhjetor 2019.

Deri në datë 01/07/2019 janë hapur këto Jira: SLA2-74 VAT REF1S; SLA2-75 VAT IMPORT dhe VAT EXPORT; SLA2-76 TPLRS; SLA2-77 LF PIT; SLA2-78 LF CIT; SLA2-95 TPLTOA; SLA2-96 TPLTOB; SLA2-97 TCTPR; SLA2-116 TPAMD VAT dhe TPAMD CIT; SLA2-117 PITINC dhe CITINC.

U bë rritestimi i rregullave TPLTOA, VATIMP, VATEXP të cilat rezultuan të suksesshme.

U bë rritestimi për rregullat TPAMD VAT & TPAMD CIT për të cilat mosperputhje të TLS.

U testua Rregulli i Riskut SBTNP i cili rezultoi në plotësim të kushteve dhe në mosperputhje të TLS-së për disa nipte.

U analizua dhe u aprovua Kërkesa për Ndryshim nr. 06 për Rregullin e Riskut VATREF1S.

## **Gusht 2019**

U testua Rregulli i Riskut TPLTOB i cili rezultoi me sukses.

U testua Rregulli i Riskut TPBPR i cili rezultoi me mosperputhje të TLS-së.

Pas rritestimeve për rregullin e riskut VATREF1S - SLA2-200 u bë ndryshimi në raportin analitik të rregullit të riskut.

U bë rritestimi i rregullit të riskut TPBPR i cili rezultoi me sukses.

## **Shtator 2019**

U analizua dhe u aprovua Kërkesa për Ndryshim nr.12 për Rregullin e Riskut VATREF1B.

U analizua dhe u aprovua KN Nr 13 - Shtojcë në Rregullin e Riskut VATREF1S. U zhvilluan testime të përbashkëta me palën mirembajtëse për Rregullin e Riskut VATREF1S.

U zhvilluan testime të përbashkëta me për Rregullin e Riskut VATREF1B.

U testuan rregullat VATG2S, VATG3S, VATG2B, VATG3B për të cilat vëmë re raste me mosperputhje të TLS-së.

U analizua dhe u aprovua KN Nr 12 - Shtojce ne Rregullin e Riskut VATREF1BU testua rregulli ALL Debt dhe iu komunikuan pales mirembajtese me ane te Jire-s SLA2-216 ndryshimet qe duhen te implementohen.

U analizua dhe u aprovua Kerkesa per Ndryshim nr.8 per Rregullin e Riskut TPAMD VAT

U analizua dhe u aprovua Kerkesa per Ndryshim nr.9 per Rregullin e Riskut TPAMDCIT.

- ✓ Gjatë muajve Gusht-Shtator, strukturat e monitorimit territorial në DHT në Rajone në zbatim të Urdhërit nr.301 datë 31.07.2019, të Ministrit të Financave “Për kryerjen e verifikimeve dhe kontrolleve në subjektet e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve”, kryen kontrolle në subjekte të fushës së hidrokarbureve në bashkëpunim me strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Nga data 1 Gusht deri më 30 Shtator janë kryer 1,117 kontrolle në subjekte të fushës së hidrokarbureve. Janë konstatuar 15 shkelje të legjislacionit tatimor dhe për 3 subjekte është marrë masa e bllokimit të shitjeve pasi tregtonin karburant në regjim manual dhe kanë vijuar procedurat e referimit pranë Sektorit të Hetimit Tatimor.

- ✓ Gjatë sezonit turistik 2019, ka patur bashkëpunim të ngushtë e të vazhdueshëm dhe me strukturat e ISHPSHSH. Janë organizuar kontrolle të përbashkëta si dhe njoftime me postë elektronike për subjektet e evidentuara me parregullsi në deklarimin e forcës punëtore nga të dyja strukturat.
  - ✓ Strukturat e Monitorimit dhe Kundërvajtjeve Administrative në DPT dhe në Rajone kanë mundësuar bashkëpunim dhe me strukturat e Policisë së Shtetit, krimin ekonomik për raste specifike.Etj.
2. Gjatë vitit 2019 Drejtoria e Hetimit Tatimor në kryerjen e detyrave funksionale ka evidentuar subjektet të cilat kanë pasur detyrime tatimore dhe për të cilat janë marrë masat administrative, po ashtu ka evidentuar raste të subjekteve të cilët kanë kryer fshehje të të ardhurave, mashtrim me TVSH-në, ose vepra të tjera penale në fushën e tatimeve dhe të taksave. Për të gjitha këto raste janë marrë masat administrative përkatëse dhe për rastet të cilat kanë përmbushur elementët e figurave të veprave penale është bërë kallëzimi i tyre në Prokuroritë përkatëse, si dhe janë ndjekur detyrat e deleguara nga Prokuroria sipas rastit.
  3. Gjatë vitit 2019 Drejtoria e Hetimit Tatimor, është angazhuar dhe ka realizuar objektivin, në lidhje me progresin organizativ të administratës tatimore dhe zhvillimin e kapaciteteve njerëzore. Në funksion të kësaj, është rishikuar dhe miratuar Manuali i Hetimit Tatimor me Urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm nr.93/1 datë 05.07.2019, me qëllim unifikimin e praktikave të ndjekura nga Drejtoria e Hetimit, në përshtatje me ndryshimet e reja strukturore të ndodhura gjatë periudhës Prill-Qershor. Janë kryer disa trajnime për stafin duke u fokusuar në ndryshimet e legjislacionit, manualin e Drejtorisë së Hetimit dhe rregulloren e funksionimit për administratën tatimore qendrore.

### **Monitorimet në terren gjatë muajve Janar-Dhjetor 2019**


Në tabelën në vijim, pasqyrohen rezultatet e kontrolleve në terren, të kryera nga strukturat e monitorimit në terren të DHT, në ndjekje dhe zbatim të Planeve Operacionale dhe në ndjekje të shkresave:

Grafik 1. Verifikimet e kryera në terren.



Në grafikun në vijim pasqyrohen në numër total, shkeljet e konstatuara nga kontrollet në terren:

Grafik 2. Shkelje të konstatuara



Shkeljet më kryesore renditen, të evidentuara sipas llojit, si më poshtë:

- ✓ **1,136** tatimpagues të penalizuar për shkeljen e moslëshimit të kuponit tatimor (rasti i parë).
- ✓ **598** tatimpagues janë penalizuar pasi janë konstatuar me punonjës të padeklaruar, nga të cilët 470 subjekte janë të përgjegjshëm tatimor “biznes i vogël” dhe 128 subjekte janë të përgjegjshëm tatimor “biznes i madh”.
- ✓ **233** tatimpagues janë konstatuar se nuk kanë pasur të instaluar pajisjet fiskale dhe **224** të tjerë nuk i mbanin pajisjet fiskale në gjendje pune.
- ✓ **878** tatimpagues janë konstatuar se dispononin mallra pa dokumentacion tatimor.
- ✓ **1,469** shkelje të tjera të legjislacionit tatimor të konstatuara.

### Subjekte të bllokuara


**657 subjekte të bllokuara, konkretisht sipas masave:**

- ✓ **70** tatimpagues u janë bllokuar ambientet për 30 ditë kalendarike për moslëshim kuponit tatimor (rast i dytë).

- ✓ **587** subjekte janë konstatuar të paregjistruara në organet tatimore, për të cilët është marrë masa e bllokimit deri në momentin e regjistrimit të tyre pranë QKB dhe organeve tatimore.

Në grafikun e mëposhtëm evidentohej vlera në total e penaliteteve të vendosura nga secili prej Rajoneve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor (Sektorët e Monitorimit Territorial), gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2019.

Grafik 3. Shkelje në vlerë sipas rajoneve



### Referime per veprat penale Janar-Dhjetor 2019


Gjatë vitit 2019, Drejtoria e Hetimit Tatimor është angazhuar në parandalimin dhe zbulimin e rasteve të evazionit fiskal. Në lidhje me këtë janë arritur rezultatet si më poshtë:

Tabela 1, Referime në prokurori


Janar- Dhjetor 2019				
Nr	Vepra penale	Neni K.P	Nr. Ref	VLERA
1	Krijimi i skemave mashtruese me TVSH	144/a	7	804,033,418.00
2	Fshehje e të ardhurave	180	123	8,503,645,009.00
3	Mospagim taksash e tatimesh	181	96	1,471,123,810.00
4	Organizim i Llotarive të palejuara	197	2	
5	Punësim i paligjshëm	170/a	33	
6	Prishja e shenjave të bllokimit apo pezullimit të veprimtarisë tregtare	182/a, 182	21	
7	Të tjera		2	
	<b>Shuma</b>		<b>284</b>	<b>10,778,802,237</b>

Sektorët e Hetimit në DPT dhe në Rajone, kanë referuar në Prokurori 284 rastë në vlerë dëmi ekonomik të shkaktuar shtetit 10,778,802,237 lekë.


Grafik 4 Referime në prokurori sipas cdo DHT



Grafik 5 Referime të veprave penale në prokurori ndër vite



Grafik nr. 6 Referimet e rasteve sipas prokurorive



Sektorët e Hetimit në DPT dhe në Rajone kanë kryer propozime për vlerësim të situatës financiare dhe propozime për kontroll për 103 raste.

#### **Denoncime/ankesa**

Trajtim i denoncimeve/ ankesave është pjesë e detyrave funksionale të strukturave të hetimit tatimor. Ndjekja e ankesave bëhet brenda një kohe sa më të shkurtër duke ruajtur të dhënat konfidenciale të denoncuesit.

Tabela 2. Ndjekja e denoncimeve

Forma e denoncimit	Nr. i denoncimeve të ardhura	Nr. i denoncimeve të trajtuara	
			Me Penalitet
Platforma Bashkqeverisjes	103	96	31
Me shkresë	3	3	1
E-mail (denoncime@tatime.gov.al)	288	251	87
Telefon-Takim (0800 14 14)	463	420	144
Tableti Ëhats App, Viber 0697073733	136	124	38
Tatimpaguesi dixhital	12	11	4
<b>TOTAL</b>	<b>1005</b>	<b>905</b>	<b>305</b>

Gjatë 2019, pranë Drejtorisë së Hetimit Tatimor kanë mbërritur nga burime të ndryshme rreth 1005 raste denoncimesh prej të cilave janë ezauruar 905 (90%) dhe nga denoncimet e trajtuara në fund të kontrolleve të ushtruara janë konstatuar rreth 305 (34%) shkelje tatimore.

Strukturat e Hetimit Tatimor, vijojnë me verifikimet për rastet e tjera deri në trajtimin e plotë të tyre.

### Zbatimi i Rekomandimeve të FMN dhe TADAT

Rekomandimet e FMN-së, janë prioritet për tu ndjekur nga Drejtoria e Hetimit Tatimor gjatë vitit 2020.

Detyrat funksionale të Drejtorisë së Hetimit Tatimor janë kryer në përputhje me rekomandimet e TADAT, të cilat vijojnë të mbeten prioritet edhe gjatë vitit 2020, ndër të tjera janë si më poshtë:

- “Mbështetja e pajtueshmërisë vullnetare”
- “Deklarimi në kohë i tatimeve”
- “Informacion i saktë dhe i besueshëm për tatimpaguesit”
- "Integriteti i bazës tatimpaguese të regjistruar"

### Aktivitetet për 2020

Në përgjigje dhe të rekomandimeve të FMN dhe TADAT, në vëmendje të punës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor për vitin 2020 do të jenë dhe aktivitetet si më poshtë:

1. Zhvillimi i një qasje që tatimpaguesit të cilët nuk përmbushin vullnetarisht detyrimet e legjislacionit tatimor, do të jenë objekt i masave efektive të forta dhe penaliteteve.
2. Fokus Sektori i Ndërtimit, juridiksionet offshore, mallrat e akcizes, transporti dhe levizja e mallrave dhe udhetareve, si dhe hidrokarburet.
3. Fokus në përmirësimin e analizës për punonjësit e paregjistruar dhe nëndeklarimin e pagave dhe marrjen e masave. Gjithashtu fokus për shenjimin e organizimeve artificiale më të përhapura.
4. Rritja e bashkëpunimit me institucione të tjera ndërvepruese në gjurmimin e veprave penale në fushën e tatimeve.
5. Gjithashtu specifikuar në planet operacionale mbi baza 3 mujore do ketë vëmendje të veçantë në Sektoret me risk dhe qytetet problematike.

## X. MARRËDHËNIET DHE KOORDINIMI INSTITUCIONAL DHE MENAXHIMI I PROJEKTEVE

### 1.1 Përshkrim i shkurtër i DMKN dhe DMP

Drejtoria e Marrëdhënieve dhe Koordinimit Ndërinstitucional është në varësi të zv. Drejtorit të Përgjithshëm të Mbështetjes së Programeve.

DMKN: organizon dhe koordinon marrëdhëniet dhe bashkëpunimin dypalësh të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me organizma ndërkombëtarë, në zbatim të aktiviteteve të Administratës Tatimore Shqiptare; siguron zbatimin e drejtë të marrëveshjeve ndërkombëtare tatimore për shmangien e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat dhe kapitalin, të ratifikuara nga Parlamenti, si dhe garanton mbrojtjen e interesave të tatimpaguesve shqiptarë në raport me transaksionet dhe marrëdhëniet me administratat tatimore të huaja.

Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve është në varësi të Drejtorit të Përgjithshëm.

Objekti i DMP-së është harmonizimi dhe koordinimi i të gjitha projekteve me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohen në Administratën Tatimore Shqiptare dhe që ndërlidhen me bashkëpunimin vendas apo ndërkombëtar, përfshirë Administratat Tatimore, Organizatat Ndërkombëtare.

### 1.2 Detyrat funksionale

Detyrat funksionale të **DMKN**-së janë:

- Sigurimi i mbarëvajtjes së bashkëpunimit dhe marrëdhënieve dypalëshe të administratës tatimore me organizmat vendase dhe të huaja.
- Raportimi në strukturat e linjës lidhur me proceset e integritetit të vendit në BE.
- Sigurimi i zbatimit korrekt, të paanshëm dhe jodiskriminues të legjislacionit tatimor dhe marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për eliminimin e taksimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal.
- Ndjekje dhe asistim në nivel teknik për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë në negociatat për marrëveshjet tatimore.

- Sigurimi i shkëmbimit të informacionit (spontan / me kërkesë) me vendet me të cilat Shqipëria ka një marrëveshje tatimore në fuqi si dhe me vendet anëtare të Forumit Global të OECD.

Detyrat funksionale të **DMP**-së janë:

- Drejtimi metodologjik i veprimtarisë së projekteve që zhvillohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve;
- Analizimi dhe kontrolli në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme të ecurisë së projekteve që zhvillohen në DPT, nxjerrjen e përgjegjësive për mangësitë dhe të metat e konstatuara dhe përcaktimi i detyrave për përmirësimin e mëtejshëm për periudhat në vazhdim;
- Ndjekja e ecurisë së zbatimit të çdo projekti me financim të brendshëm apo të huaj që zhvillohet në DPT, deri në përfundim të tij;
- Verifikimi dhe analizimi i rezultateve të punës së kryer për çdo projekt në zbatim të legjislacionit në fuqi;
- Bashkëpunimi me funksionet e tjera në DPT dhe në DRT në varësi të fushës së zbatimit të çdo projekti për të bërë të mundur funksionimin normal të faqes zyrtare të internetit, si dhe publikimin e materialeve në të, si dhe për të siguruar trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve në lidhje me ndryshimet e legjislacionit tatimor apo për çështje të caktuara tatimore.

### **1.3 Struktura**

Me ndryshimet e strukturës me te fundit organizative te DPT-se, prej muajit maj 2019 DMKN përbëhet nga 1 Drejtor + 2 përgjegjës sektori + 10 inspektorë.

Para këtij ndryshimi, përbërja ishte 1+2+6. Sektorit të Marrëveshjeve të Taksimit të Dyfishtë iu shtuan 4 inspektorë me qëllim përballimin e ngarkesës së madhe që ky sektor ka në vijimësi, por edhe për të zbatuar rekomandimin që Komisioni European e ka paraqitur në Progres-Raportet për Shqipërinë në 2017 e 2018, lidhur me krijimin e strukturës së dedikuar për të gjitha llojet e shkëmbimit të informacionit (spontan / me kërkesë / automatik) mes administratave tatimore (që në shumicën e administratave tatimore emërtohet Central Liaison Office - CLO).

DMP-ja është e organizuar në strukturën 1+5 (Drejtori i Drejtorisë dhe 5 Inspektorë të Parë).

Aktualisht, DMP-ja operon në kushtet e dy vakancave: Drejtori i Drejtorisë, si dhe një Inspektor i Parë.

#### 1.4 Stafi aktual

- Sektori i Koordinimit të Projekteve: 1 përgjegjës sektori; 1 inspektor; 2 ekselentë.
- Sektori i Marrëveshjeve dhe Eleminimit të Taksimit të Dyfishtë: 1 përgjegjës sektori; 2 inspektorë; 3 ekselentë; 2 vende vakante.

Përsa i përket DMP-së, më poshtë renditen emrat e Inspektorëve:

1. Blerina Paja – Inspektor i Parë i transferuar në DMP nga një institucion i jashtëm për një periudhë kohore 6-mujore;
2. Fjona Kurteshi - Inspektor i Parë i punësuar me kontratë për një periudhë kohore 1-vjeçare;
3. Ilira Tasho - Inspektor i Parë i transferuar nga DMP-ja në DRT-në Tiranë;
4. Ina Serani - Inspektor i Parë, aktualisht me leje lindjeje.

## 2. Objektivat e për vitin 2019

### 2.1 Objektivat strategjikë të **DMKN**

Objektivat e DMKN-së për vitin 2019:

**Objektivi strategjik 1:** Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare

1.1 Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

1.2 Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njehsuese

**Objektivi strategjik 2:** Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor

2.1 Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore

**Objektivi strategjik 3:** Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

3.1 Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

### 3.2 Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

#### 2.2 Objektivat strategjikë të DMP

Objektivat e DMP-së për vitin 2019 janë të bazuara në Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën kohore 2017-2021 dhe janë të organizuara si më poshtë:

Objektivi	Nënobjektivi	Treguesit kryesorë të performancës
<b>1:</b> Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare	<b>1.1:</b> Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore	Krijimi i mjeteve informuese për tatimpagues dhe individë, pranë Shërbimit të Tatimpaguesit
<b>3:</b> Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore	<b>3.1:</b> Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një Administratë Tatimore Moderne	Organizimi i vizitave nga ekspertë të jashtëm
	<b>3.3:</b> Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore	Ndjekja e zbatimit të projektit “Shkëmbimi Automatik i Informacionit”
	<b>3.4:</b> Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve	Aplikime për projekte të reja sipas nevojave të institucionit

#### 2.3 Treguesit kryesorë të performancës

- Trajtim cilësor dhe në kohë sa më të shkurtër i kërkesave të tatimpaguesve për zbatimin e marrëveshjeve të eliminimit të taksimit të dyfishtë,
- Kontribut në grupin e punës të ngritur për zbatimin e projektit pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Përmirësimi i njohurive të stafit, përmes pjesëmarrjes sa më të gjerë në trajnimet e organizuara nga organizatat ndërkombëtare, vizitave studimore në administratat homologe apo sjelljes së ekspertëve të huaj të fushave të caktuara.
- Menaxhimi dhe koordinimi i kontributit të DPT në procesin e integritetit në BE.

## 2.4 Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT

Nuk ka.

## 3. Aktivitetet e programuara dhe realizuar gjatë 2019 në funksion të realizimit të objektivave.

### 3.1 Sektori i Marrëveshjeve dhe Eleminimit të Taksimit të Dyfishtë

Në kuadër të ofrimit të shërbimeve cilësore për tatimpaguesit:

- Iu është përgjigjur mbi 2,200 kërkesave nga tatimpaguesit për zbatimin e marrëveshjeve tatimore ndërkombëtare për shmangien e taksimit të dyfishtë, që Shqipëria ka lidhur me 40 shtete;
- Iu është përgjigjur mbi 530 kërkesave të tatimpaguesve dhe individëve për t'u pajisur me certifikatë rezidence;
- 50 kërkesa për shkëmbim informacioni nga / drejt administratave tatimore homologe.
- Ka asistuar drejtoritë e tjera në DPT si dhe Drejtoritë Rajonale në lidhje me probleme dhe paqartësi në zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë;
- Ka përpiluar programet e trajnimit dhe ka trajnuar stafin e ri / aktual të administratës tatimore mbi zbatimin e marrëveshjeve për shmangien e taksimit të dyfishtë.
- Ka dhënë kontribut për grupin e punës të ngritur në kuadër të Projektit Pilot për Shkëmbimin Automatik të Informacionit, që po zbatohet (2018-2020) me ndihmesën e OECD dhe Administratës Tatimore Italiane;

### 3.2 Sektori i Koordinimit të Projekteve

Në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave, studimit dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit, ka organizuar pjesëmarrjen e stafit të Administratës Tatimore në aktivitetet si vijon:

- o 9 seminare/trajnime (16 punonjës të trajnuar) dhe 1 webinar (4 punonjës të trajnuar) organizuar nga Organizata Ndër-Europiane e Administratave Tatimore (IOTA).
- o 2 trajnime (6 punonjës të trajnuar) organizuar nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD).
- o 1 seminar online (5 punonjës të trajnuar) dhe 2 trajnime (3 punonjës të trajnuar), organizuar nga Qendra e Ekselencës Financiare (CEF).

- o 4 trajnime (5 punonjës të trajnuar) organizuar në kuadër të programit të BE Fiscalis 2020.
- o Në kuadër të programit TAIEX janë organizuar në Tiranë, 3 misione me ekspertë të huaj, që kanë asistuar:

a) Drejtorinë Ligjore + Kontrollit: “Politikat tatimore dhe standardet e aplikuara në lidhje me legjislacionin TVSH”, Shkurt 2019 - 18 pjesëmarrës (DPT+DRT);

b) Drejtorinë e Hetimit Tatimor: “Forcimi i Investigimeve Financiare dhe Hetimi mbi Mashtrimin e TVSH-së”, Tetor 2019, 17 pjesëmarrës (DPT+DRT);

c) Drejtorinë e Mbledhjes së Detyrimeve të Papaguara: “Përmirësimi i efektivitetit të procedurave të mbledhjes së borxheve”, Nëntor 2019 - 16 pjesëmarrës (DPT+DRT);

- o 2 Takime në kuadër të procesit screening për Kapitullin 16 “Tatimet” dhe Kapitullin 33 “Dispozitat financiare dhe buxhetore”, 2 Takime në kuadër të Nënkomitetit “Çështjet Ekonomike, Financiare dhe Statistikat” si dhe KSA - Komiteti Stabilizim Asociimit; u organizua pjesëmarrja në Takimin Rajonal të Ministrave dhe Drejtorëve të Përgjithshëm të AT, në Becici, Mali i Zi, si dhe pjesëmarrja në Konferencën e nivelit të lartë drejtues mbi “Strategjinë afatmesme të të ardhurave - Ndërtimi i sistemeve efektive Tatimore” (FMN).

- o Në kuadër të programit CEPOL dhe programit të trajnimit të brendshëm mbi Hetimet Financiare për Ballkanin Perëndimor u organizuan 2 trajnime online për Drejtorinë e Hetimit Tatimor, dhe 1 takim në Paris i Ekipit Vlerësues FATF të Moneyval.

- o Raportim në strukturat e linjës lidhur me proceset e integritetit në BE; përgatitja e informacioneve mbi progresin e Administratës Tatimore Shqiptare në kuadër të:

- ☐ Kontributi Irë për Raportin e Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020.
- ☐ Kapitulli 16 “Tatimet”, Kapitulli 33 “Kriteri Ekonomik”, Kapitulli 20 “Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale”.
- ☐ Takimi i 10të i KSA “Komiteti i Stabilizim Asociimit”, 14 nëntor 2019.
- ☐ Takimi i 11të i Nënkomitetit Çështjet Ekonomiko-Financiare dhe Statistikat, 3 Tetor 2019.
- ☐ Raportim në kuadër të PKIE (Planit Kombëtar të Integritetit).

- Raportimi i përvitshëm “Doing Business” (indikatori Paying Taxes) të Bankës Botërore
- Raportimit për Monitorimin 6-mujor të Strategjisë së Menaxhimit të Financave Publike - PFM Action Plan, për Komponentin 3.1 ‘Tax Administration’.

### 3.3 Drejtoria e Menaxhimit të Projekteve

Në përmbushje të nënobjektivit 1.1: “Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore”, si pjesë e objektivit 1: “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”, DMP-ja, në bashkëpunim me DSHT-në ka pasur të programuar sigurimin e informacionit të plotë, të kuptueshëm në kohë dhe të aksesueshëm në lidhje me përmbushjen, duke krijuar mjete informuese për tatimpagues dhe individë, pranë Shërbimit të Tatimpaguesit. Në kuadër të përmbushjes së këtij aktiviteti të programuar, gjatë vitit 2019 është krijuar një platformë Helpdesk-u, është ngritur një sportel i veçantë informues për tatimpagues dhe individë pranë qendrave ADISA, janë përditësuar video dhe broshura informuese, është bërë fushatë sponsorship në media dhe rrjete sociale.

Në përmbushje të nënobjektivit 3.1: “Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një Administratë Tatimore Moderne”, si pjesë e objektivit 3: “Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore”, DMP-ja ka organizuar dhe ndjekur vizitat nga ekspertë të jashtëm me qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe zbatimin e praktikave më të mira ndërkombëtare në lidhje me sistemet e menaxhimit. Konkretisht, aktivitete e realizuar, renditen si më poshtë:

1. 6 Shkurt 2019 Banka Botërore, takim me ekspertet e BB, z. Elëyn Davies dhe z. Christoph Ungerer me fokus për lehtësirat fiskale , efektet e tyre dhe reformat për rritjen e të ardhurave;
2. 11-28 Shkurt 2019 asistencë nga eksperti i FMN, z. Steve Howlin për Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Drejtorinë e Kontrollit Tatimor (Plani Sektorial i Bar Restoranteve;
3. 27 Shkurt 2019 Banka Botërore, takim me ekspertin znj. Christina Irma Donna me fokus mbi analizen analitike dhe teknike mes taksave dhe kontabilitetit;
4. 27 Shkurt-19 Mars 2019 asistencë nga eksperti i FMN, z. Paul Duffus për Drejtorinë e Mbledhjes me Forcë;
5. 3 -16 Prill 2019 asistencë nga eksperti i FMN, z.Keith Kartëright për Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj;

6. 5-19 Nëntor 2019, mision nga ekspertë të FMN, 1. Z. Stephen John Vesperman, Z. Paul James Dempsey, Z. Allan Leon Jensen, Z. Michael O'Grady Z. Barrie Russell për të asistuar në hartimin e një Strategjie afat-mesme të të ardhurave;
7. 20 Nëntor - 6 Dhjetor 2019, asistencë nga eksperti i FMN, z. Steve Howlin për të asistuar në përmirësimin e menaxhimit të riskut të përmbushjes tatimore;
8. 2 - 13 Dhjetor 2019, asistencë nga eksperti i FMN, z. Paul Martens, për të asistuar në përmirësimin e programit të kontrollit tatimor;
9. 4-17 Dhjetor, asistencë nga eksperti i FMN, z. Keith Kartwright për Drejtorinë Rajonale të Tatimpaguesve të Mëdhenj;

Në përmbushje të nënobjektivit 3.3: “Mbajtja e proceseve optimale dhe struktura e Administratës Tatimore”, si pjesë e objektivit 3: “Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore”, DMP-ja ka ndjekur zbatimin e projektit “Shkëmbimi Automatik i Informacionit”. Ky projekt bazohet në Ligji Nr. 146/2013, datë 06.05.2013 “Për Ratifikimin e Konventës për Ndihmën Administrative të Ndërsjellë në Çështjet Tatimore”, i cili në nenin 6 të tij ka parashikuar që vendet shkëmbejnë automatikisht informacionin tatimor si dhe në “Marrëveshjen Shumëpalëshe të Autoriteteve Kompetente për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, nënshkruar më datë 29.10.2014, miratuar me VKM Nr. 178, datë 09.03.2016.

Objektivi i përgjithshëm i projektit është të kontribuojë në adoptimin dhe zbatimin e Shkëmbimit Automatik të Informacionit në llogaritë financiare për qëllime tatimore, sipas standarteve të përbashkëta të raportimit.

Informacioni për t'u shkëmbyer përfshin llogaritë financiare, duke përfshirë bilancet, interesat, dividendët, të drejtat dhe të ardhurat nga shitja e aseteve financiare të raportuara te qeveritë nga institucionet financiare, duke mbuluar llogaritë e mbajtura nga individët dhe entitetet përfshirë trustet dhe fondacionet.

Gjatë viti 2019, është draftuar projektligji “Për Shkëmbimin Automatik të Informacionit të Llogarive Financiare”, ka kaluar në Këshillin e Ministrave dhe pritet të miratohet brenda Janarit të vitit 2020. Bazuar në këtë projektligj, Këshilli i Ministrave do të nxjerrë aktet nënligjore jo më vonë se 3 muaj nga data e hyrjes në fuqi të tij.

Pala italiane ka hartuar dy versione propozimi mbi arkitekturën e infrastrukturës së IT-së, përkatësisht (i) Shkëmbimin e të dhënave përmes FTP dhe (ii) Shkëmbimin e të dhënave përmes Shërbimit Web SOAP, duke theksuar se zgjidhja nën (i) jo vetëm që pasqyron atë të miratuar nga Italia, por është gjithashtu më pak e kushtueshme. Gjatë takimit të datës 15.11.2019, është vendosur që DPT të përdorë sistemin FTP, duke qenë se pjesa më e madhe e bankave janë pro sistemit FTP, si dhe ky sistem është më pak i kushtueshëm.

Gjatë kësaj periudhe është organizuar 1 takim i Komitetit Drejtues, më datë 27.06.2019, me qëllim diskutimin mbi problematikat e hasura gjatë periudhës së zbatimit si dhe ecurinë e projektit.

Gjithashtu si mjet për të monitoruar zbatimin e projektit kanë qenë edhe conference call zhvilluar ndërmjet DPT, OECD dhe palës italiane, si dhe takimet periodike të grupit të punës në DPT.

#### 4. Aktivitete jo të parashikuara në planifikimin fillestar, por të realizuara gjatë vitit 2019

DMKN: Në bashkëpunim me stafin e IT në muajin maj 2019 u mundësua lëshimi nga portali e-albania i certifikatave të rezidencës tatimore për tatimpaguesit.

#### DMP: PROJEKTI I FISKALIZIMIT SI RISI PËR ADMINISTRATËN TATIMORE

Përgjatë vitit 2019, pavarësisht mosparashikimit në paraprak, DMP-ja është përfshirë në ndjekjen e Projektit “Për Përmirësimin e Modullit të Menaxhimit të Kontrollit të Faturimit”, njohur ndryshe si Projekti i Fiskalizimit, duke funksionuar si Sekretariat Teknik në mbështetje të realizimit të tij.

Duke filluar që nga data 27.11.2018 ka filluar implementimi i Projektit të Fiskalizimit. Ky projekt shënon një reformë të thellë në raportimin fiskal dhe administrimin tatimor të të dhënave.

Vitet e fundit në Administratën Tatimore ka pasur një zhvillim thelbësor në fushën e Teknologjisë së Informacionit, për të ripërtërirë teknologjinë informative, në funksion të rritjes së efikasitetit të AT, përmirësimit të shërbimeve ndaj tatimpaguesve - lehtësimin dhe disponueshmërinë e funksioneve të sistemeve për tatimpaguesit.

Procesi i Fiskalizimit mundëson që procedurat e inspektimit tatimor të jenë transparente dhe efikase, duke e bërë kontrollin tatimor më efikas; rritje të ndërgjegjësimit për rëndësinë e kësaj çështjeje dhe zhvillimin e tregut të shërbimeve të IT-së, duke krijuar kushtet për konkurrencë të barabartë në treg.

Fiskalizimi është i bazuar në software dhe procesi mund të implementohet lehtësisht në të gjitha paisjet ekzistuese fiskale (pa pasur nevojë për një paisje software secondare vetëm për të operuar brenda sistemit të fiskalizimit). Në terma afatgjatë kjo ul ndjeshëm kostot e teknologjisë për tatimpaguesit.

Ky sistem ofron parakushte për një luftë të suksesshme kundër evazionit fiskal, mbështetur në komunikimin paisje – paisje (Tax Mashine To Tax Machine), ku fiton peshë post-analiza; nuk bëhet fjalë vetëm për mbledhjen dhe ruajtjen e një numri të madh të të dhënave.

Me këtë sistem do të kemi pasqyrë dhe monitorim në kohë reale të transaksioneve financiare, analizë të detajuar dhe parashikuese; analizë të riskut sipas modelit matricor duke përdorur të gjitha të dhënat e disponueshme nga AT në mënyrë proaktive.

Ka shumë përfitime dhe rezultate të pritshme nga ky system, ndërsa të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me DPT-në janë:

□ Mbledhje më e mirë e taksave në shkallë vendi, ku zëri kryesor mbetet Tatimi mbi Vlerën e Shtuar. Duke iu referuar rezultateve të arritura në vendet e tjera që zbatojnë këtë sistem, në mbledhjen e TVSH-së janë regjistruar rritje nga 10-15%, krahasuar me të ardhurat nga TVSH-ja, përpara aplikimit të këtij sistemi. Rritje priten edhe në kategori të tjera taksash (psh. Tatimi mbi të Ardhurat).

□ Ulje e informalitetit – duke përmirësuar dy aspekte kryesore – raportimi i më shumë transaksioneve me para në dorë dhe ulja e transaksioneve të fshehura pa para në dorë, me një kontroll më të mirë të sistemit fiskal, do të reduktohet informaliteti në ekonominë shqiptare.

□ Rritje e eficiencës në raportimin tatimor – me më shumë informacion të mbledhur nga një tatimpagues, Administrata Tatimore do të jetë në gjendje t'i ofrojë një shërbim më të mirë tatimpaguesit, si plotësim paraprak i faturave të TVSH-së me të dhëna tashmë të gatshme të tatimpaguesit. Zvogëlimi i gabimeve në lidhje me elementët e faturës dhe TVSH-në e ngarkuar; Automatizimi i librave të shitjes dhe blerjeve dhe deklarimi i TVSH-së, të paraplotësuar bazuar në të dhënat e mbledhura nga faturimi në kohë reale; Mundëson ndjekjen e afateve të pagesës në kuadër të transaksioneve B2B dhe kështu mund të shërbejë si një mekanizëm rregullator për Direktivën e

Pagesave të vonshme në Transaksionet e Biznesit. Kjo do të përshpejtojë raportimin tatimor dhe reduktojë gabimet në këtë proces.

☐ Përmirësim i kontrollit tatimor dhe verifikimit në terren – duke përdorur sistemin e fiskalizimit, mundësohet kontrolli dhe inspektimi tatimor mbi bazën e riskut, çka do të rezultojë në identifikimin e drejtëpërdrejtë të abuzuesve, duke shmangur kështu inspektimet në bizneset e rregullta.

Projekti i Fiskalizimit sjell një sistem modern me një gamë më të gjerë përdorimi, i cili e përafron Shqipërinë me praktikën bashkëkohore të vendeve të tjera, duke shtruar rrugën për fuqizimin e ekonomisë shqiptare, përmes formalizimit të saj.

Elementet teknike të projektit janë:

- Një sistem për ndjekjen e të gjitha transaksioneve në kohë reale - në momentin e lëshimit të faturës për transaksionet cash (B2C) dhe ato pa para në dorë (B2B, B2G);
- Një sistem për monitorimin e pagesave jo cash (nga një llogari bankare në tjetrën dhe pagesa opsionale duke përdorur para dixhitale etj.), me qëllim gjurmimin e rrjedhës së parave dhe zbulimin më të mirë të aktiviteteve mashtruese, marrëveshjeve jo të vërteta ose transaksioneve fiktive;
- Një sistem të Faturave elektronike për çdo transaksion jo-cash të B2B dhe B2G, duke përfshirë një Portal të ri Kombëtar në website për Shkëmbimin e faturave elektronike;
- Një sistem i ri i regjistrimit të tatimpagueseve dhe regjistrimit të aseteve të tatimpaguesit;
- eAudit, ose kontrolli tatimor online i transaksioneve me para në dorë duke përfshirë edhe GeoTax;
- Procedura e re e kontrollit tatimor për monitortimin e transaksioneve me dhe pa para në dorë;
- Sistemi i ri i menaxhimit të riskut (RMS) për tatimpaguesit e nënsistemit të pagesave me para në dorë.

Administrata Tatimore do të ketë informacion në kohë reale mbi:

- ☐ Të gjitha transaksionet e kryera;
- ☐ Të gjitha faturat e lëshuara;

☐ Shumën e përgjithshme të të ardhurave të të gjithë tatimpaguesve, në të gjithë sektorët, ose vetëm në një sektor, ose vetëm nga një tatimpagues.

Në këtë mënyrë, ky projekt adreson dy sfidat kryesore të çdo Administrate Tatimore:

☐ Monitorimi i kontrollit të parave në dorë (cash) - kryesisht i pranishëm në transaksione të bazuara në para (B2C), zbatimi i lidhjes në kohë reale në internet të të gjitha makinave POS për të siguruar që çdo transaksion të raportohet në mënyrë qendrore, me aftësinë e verifikimit të pavarur.

☐ Rrritja fiktive e TVSH-së së zbritshme - projekti e-Invoice - kryesisht i pranishëm në transaksionet (B2B), - raportim i detyrueshëm i të gjitha faturave të lëshuara përmes sistemit qendror që siguron konfirmimin e të gjitha transaksioneve nga shitësi dhe klienti.

Më datë 20.01.2020 është botuar në Fletoren Zyrtare Ligji Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i cili hyn në fuqi më datë 04.02.2020.

Sipas këtij Ligji, efektet sipas llojit të transaksioni janë si më poshtë:

a) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim fitimit me të ardhura vjetore mbi 8 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 shtator 2020;

b) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit mbi vlerën e shtuar dhe tatim të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore mbi 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021;

c) Për transaksionet me para në dorë nga tatimpaguesit subjekt të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin me të ardhura vjetore deri në 2 milionë lekë, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021;

ç) Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve dhe organeve publike, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 janar 2021;

d) Për transaksionet pa para në dorë ndërmjet tatimpaguesve, efektet e këtij ligji fillojnë më 1 korrik 2021.

Në vijim të Urdhërit Nr. 48, datë 08.08.2019 dhe Urdhërit Nr. 59, datë 02.10.2019 “Për ngritjen e grupit të punës për implementimin e projektit “Për përmirësimin e modulit të menaxhimit të kontrollit të faturimit”, DMP-ja është e angazhuar në përmbushjen e detyrave të mëposhtme:

- Siguron mirëdokumentimin dhe qarkullimin në mënyrën e duhur të çdo materiali (dokumenti) që lidhet me Projektin e Fiskalizimit, si dhe kujdeset për cilësinë formale dhe përmbajtësore të këtij materiali (dokumentacioni);
- Shpërndan për shqyrtim te Grupi i Punës për Fiskalizimin dhe te drejtorët respektivë të drejtorive që lidhen me çështjen dokumentet që dërgohen nga pala kontraktore, duke kërkuar nga këto vrejtjet apo sugjerimet e rastit (nëse ka), si dhe konfirmimin ose jo të dokumentit;
- Koordinon punën brenda institucionit dhe siguron bashkëpunimin me kontraktorin duke siguruar të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për përmbushjen e detyrave sipas afateve të përcaktuara;
- Monitoron zbatimin e planit të punës së njësive duke siguruar respektimin e afateve kohore për çdo aktivitet;
- Monitoron në vijimësi statusin e realizimit të çdo detyre, njofton palët respektive për afatet kohore që duhen respektuar në bazë të kontratës dhe kur është rasti sinjalizon palët për çdo vonesë të konstatuar;
- Koordinon dhe organizon takimet ndërmjet kontraktuesit dhe Grupit të Punës për Fiskalizimin dhe strukturave të tjera të administratës tatimore në kuadër të zbatimit të kontratës dhe termave të referencës;
- Funksionon si pikë kontakti për projektin;
- Përgatit agjendën, njoftimet, sigurimin e ambienteve të përshtatshme, infrastrukturën IT për takimet;
- Mban minutat e takimit për çdo mbledhje të Grupit të Punës për Fiskalizimin dhe të Grupit të Menaxhimit të Projektit;
- Ruan dhe përditëson dosjet e projektit;
- Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga drejtuesi i projektit në përmbushje të detyrimeve sipas këtij Urdhri.

5. Aktivitete të porealizuara ose të papërfunduara (arsyet dhe afatet e përfundimit)

Fisha e projektit të asistencës nga administrata suedeze, dërguar Ambasadës Suedeze në Tiranë në maj 2019 për miratim financimi, u kthye prej tyre në dhjetor 2019 me kërkesën për zgjerimin e fushave të kësaj asistence për më shumë Drejtori/funksione nga sa ishte parashikuar.

Po punohet për ta përditësuar këtë fishë me rekomandimet më të fundit të FMN dhe me nevojat që rrjedhin prej tyre për të gjitha Drejtoritë në DPT.

6. Sa dhe si ndikuan këto aktivitete në arritjen e objektivave të përcaktuara.

Lidhur me trajtimin e kërkesave të tatimpaguesve për zbatimin e marrëveshjeve të taksimit të dyfishtë, gjatë vitit 2019 u përmirësua ndjeshëm koha mesatare e kthimit të përgjigjes drejt tatimpaguesit.

7. Problematikat e hasura në realizimin e aktiviteteve gjatë vitit 2019.

Për sa i përket projektit “Shkëmbimi Automatik i Informacionit”, afatet për zbatimin e aktiviteteve të këtij projekti janë tejkaluar, për shkak të vonesave në miratimin e projekt-ligjit “Për shkëmbimin automatik të informacionit të llogarive financiare”.

Në lidhje me projektin e Fiskalizimit problematikat kanë qenë si më poshtë:

- a) Miratimi me vonesë i ligjit shkaktoi shtyrjen në kohë të disa prej fazave të Projektit;
- b) Fazat e implementimit të Projektit (Ligji) nga Janar 2020 (parashikur fillimisht) u shty për në Shtator 2020 dhe në vijim;
- c) Vështirësia në përshtatjen e pajisjeve fiskale aktuale para hyrjes në fuqi të Ligjit me kërkesat teknike të Fiskalizimit.

## **8. Objektivat e Drejtorisë për vitin 2020**

### **8.1 Nga Plani Strategjik 2017 – 2021 i DPT**

Objektivi strategjik 1: Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare.

1.1 Ofrimi i shërbimeve cilësore dhe reduktimi i barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore.

1.3 Zbatimi i metodologjive dhe praktikave njëhsuese

Objektivi strategjik 2: Zbatimi efikas i legjislacionit tatimor dhe sigurimeve shoqërore, dhe hetimi i rasteve të mashtrimit tatimor

## 2.2 Përmirësimi i mëtejshëm i kontrollit tatimor dhe gjurmimi i mashtrimeve tatimore

Objektivi strategjik 3: Progresi organizativ i Administratës Tatimore dhe zhvillimi i kapaciteteve njerëzore.

### 3.1 Aplikimi i metodave dhe sistemeve për të menaxhuar një AT moderne

### 3.4. Zhvillimi dhe përmirësimi i partneriteteve

## 8.2 Objektivat e DMP për vitin 2020

Objektivi kryesor i DMP është të kryejë dhe ndjekë zbatimin e Projekteve që institucioni përfiton nga buxheti i shtetit, si dhe bashkëpunimi me donatorë të huaj. Gjatë vitit 2020, DMP ka si objektiv:

1. Programimin dhe zbatimin teknik të projekteve si dhe koordinimin e punës me drejtoritë teknike në DPT dhe institucionet e tjera, të përfshira për realizimin në kohë të kësaj detyre.
2. Pritja dhe përcjellja e misionëve të huaja, në kuadër të shkëmbimit të eksperiencave dhe zbatimit të praktikave më të mira ndërkombëtare.
3. Aplikime për projekte të reja sipas nevojave të institucionit.

## 8.3 Nga rekomandimet e fundit të FMN

III.3 Dhënia e stimuljeve për të pastruar evazionin e mëparshëm në lidhje me juridiksionet offshore nëpërmjet një programi të deklarimit vullnetar të parregullsive në periudhën paraprake deri në shkëmbimin e parë automatik.

III.3.1 Në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore, DMKN do të kryejë rishikimin e legjislacionit në fuqi dhe propozimi i ndryshimeve në kuadër të programit të deklarimit vullnetar të parregullsive lidhur me juridiksionet offshore.

VIII.3. Marrja e produkteve të përshtatshme CAAT dhe lidhja e partneriteteve me institucionet e tjera tatimore që i përdorin këto produkte, për të trajnuar inspektorët e kontrollit për to.

VIII.3.1 Pasi të identifikohet nga Dr. e Kontrollit produkti CAAT që do të përdoret nga DPT, do t'i drejtohem administratave që përdorin këto produkte për të dërguar ekspertët e tyre për të trajnuar stafin tonë (1 javë).

## **9. Aktivitet e parashikuara te realizohen për vitin 2020 në funksion të realizimit të objektivave.**

### **9.1 DMKN:**

- Do të trajtohen problematika fiskale në lidhje me zbatimin e marrëveshjeve tatimore duke u mbështetur në ligj, për tatimpaguesit dhe administratën tatimore qendrore;
- Do të propozohen ndryshime të mundshme ligjore dhe do të ndiqen marrëveshjet në nivel praktik;
- Me kërkesën e Ministrisë së Financave do të merret pjesë në negociatat në nivel teknik për përfundimin e marrëveshjeve të reja për eliminimin e taksimit të dyfishtë.
- Do të kryhet shkëmbimi i informacionit (spontan dhe me kërkesë) me Administratat Tatimore te vendeve te tjera lidhur me të dhëna mbi transaksionet e realizuara ndërmjet tatimpaguesve;
- Do të përditësohen kurrikulat e trajnimit mbi legjislacionin në fuqi për shmangien e taksimit të dyfishtë, në kuadër të trajnimeve që organizon DPT për punonjësit e rinj të ATQ;
- Do të vijojë kontributi në grupin e punës për projektin pilot mbi shkëmbimin automatik të informacionit sipas standardeve të OECD.
- Do të organizohet pjesëmarrja e personelit të administratës tatimore në mbi 35 aktivitete dhe trajnime te planifikuara nga organizatat ndërkombëtare si IOTA, OECD, dhe CEF;
- Janë planifikuar të zhvillohen 2 vizita studimore pranë administratave homologe me tematika specifike, në kuadër të programit FISCALIS 2020.
- Do të organizohet 1 mision ekspertësh nga BE, në kuadër të asistencës teknike ofruar nga programi TAIEX, për Shërbimin e Tatimpaguesve dhe 1 mision ekspertësh nga BE për Menaxhimin e Borxhit.
- Në bashkëpunim me Drejtorinë Ligjore dhe Teknike, do të hartohet propozim për ndryshime ligjore në kuadër të programit të deklarimit vullnetar te parregullsive lidhur me juridiksionet offshore.

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Kontrollit, do të sillen ekspertë nga administratat homologe për trajnimin e stafit tonë mbi përdorimin e produktit CAAT dhe mbi metodat e tërthorta të kontrollit tatimor (TAIEX ose Tax Inspectors Without Borders).

## **9.2 DMP:**

Aktivitetet e vazhdueshme:

- a) Zbatimin e Projektit të Shkëmbimit Automatik të informacionit - gjatë vitit 2020 parashikohet të përfundojë edhe legjislacioni dytësor, si dhe të implementohet infrastruktura IT. Drejtoria do të ndjekë ecurinë e projektit, si dhe do të koordinojë takimet e ndryshme në kuadër të projektit. (organizimi i mbledhjeve të Komitetit Drejtues, takimet e grupit të punës, etj.).
- b) Zbatimin e Projektit të Fiskalizimit - gjatë vitit 2020 Drejtoria do të vazhdojë të ndjekë implementimin e Projektit të Fiskalizimit, duke ndjekur fazat në të cilat procesi i fiskalizimit do të kalojë, duke ruajtur dokumentacionin përkatës, shërbyer si pikë kontakti, dokumentuar aktivitetet që do të zhvillohen.
- c) Ndjekjen e misionëve të huaja – në këtë kuadër, gjatë vitit 2020, Drejtoria do të ndjekë organizimin logjistik të misionëve të FMN në DPT dhe do të koordinojë punën me drejtoritë përkatëse me të cilat FMN do të bashkëpunojë.

## **Aktivitetet e reja:**

- a) Zbatimin e Projektit të financuar nga Banka Botërore si dhe atij të financuar nga Sida. Këto projekte janë në fazën fillestare të tyre. DPT ka dërguar pranë secilit institucion nevojën për mbështetje dhe në këtë kuadër është përgatitur dokumenti i aplikimit për fonde. Këto projekte parashikohen të fillojnë gjatë vitit 2020.

## **10. Projekte të ndërmarra në bashkëpunim me organizma ndërkombëtarë për 2020.**

- o Po punohet për një bashkëpunim me Administratën Tatimore të Suedisë dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë, përmes një mini-projekti të asistencës që do të ofrohet për Administratën tatimore. Aktualisht në këtë asistencë janë të përfshirë: Drejtoria e Hetimit Tatimor, Drejtoria DIBA

dhe Drejtoria e Shërbimit Tatimpaguesve. Gjithashtu, është menduar që kjo asistencë të përfshijë një kuadër më të gjerë të nevojave të Administratës tatimore.

o DMKN në bashkëpunim me Drejtorinë e Menaxhimit të Projekteve në DPT, dhe të asistuar nga përfaqësuesit e Bankës Botërore në Shqipëri, do punojë për një projekt asistence 2-vjeçar mbi:

- Fuqizimi i përmbushjes tatimore
- Përdorimi i metodave të sjelljes në komunikimin me tatimpaguesit
- Lehtësimi i pagesës së taksave përmes orientimit të administratës tatimore në ofrimin e shërbimeve.

#### **11. Kërkesat e DMKN për vitin 2020**

- Trajnime – trajnime të gjuhës angleze do të ishin të nevojshme për përmirësimin e njohurive të stafit.
- Për infrastrukture IT – nuk ka nevoja.
- Për financim me buxhet – nuk ka nevoja.
- Për ambiente – stafi i sektorit të Marrëveshjeve, aktualisht me 6 punonjës (dhe 2 vende vakante) ka nevojë për një zyrë më të madhe ose për një zyrë të dytë.
- Të tjera kërkesa – Nuk ka.

#### **12. Kërkesat e DMP për vitin 2020**

Nevojat e Drejtorisë së Menaxhimit të Projekteve përshkruhen si më poshtë:

1) Nevoja për staf – duke qenë se aktualisht në DMP janë vetëm 2 inspektorë, nga të cilët njëri prej tyre është i dedikuar për projektin e Fiskalizimit dhe inspektori tjetër për ndjekjen e detyrave të tjera të drejtorisë, lind nevoja për staf shtesë në mënyrë që DMP të mund të ndjekë në kohë projektet e reja që do të zbatohen gjatë vitit 2020.

2) Nevoja për trajnime (trajnime profesionale, trajnime të ndryshme të nevojshme për rritjen e kapaciteteve) më në detaj:

a) Trajnime mbi menaxhimin e Projekte të certifikuara nga ASPA si dhe trajnime të tjera plotësuese për të marrë njohuri të plota mbi hapat e aplikimit dhe monitorimit të projekteve, duke përfshirë ciklin e menaxhimit të projekteve dhe qasjen e kuadrit logjik të tyre;

b) Njohuri mbi identifikimi i risqeve dhe plani i parandalimit të tyre, përgatitja e projekt fishave, përgatitja e concept note, monitorimi i implementimit të projekteve, përgatitja e raporteve, etj.

## **XI.BURIMET NJEREZORE**

### **A) STRUKTURA ORGANIZATIVE**

#### **REKOMANDIME TË FMN**

#### **AKTIVITETE TË REJA NË VITIN 2020**

#### **STRUKTURA ORGANIZATIVE**

Administrata Tatimore Qendrore, deri në 27.02.2019, ushtronte funksionimin e saj në zbatim të Strukturës Organizative të miratuar me Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", sipas së cilës numri plan i miratuar i personelit të ATQ ishte 1569 punonjësish/nëpunësish, prej të cilëve 1159 janë nëpunës civil dhe 410 punonjës të cilët trajtohen me dispozita të Kodit të Punës.

Administrata Tatimore Qendrore, përgjatë vitit 2019, i është nënshtruar dy procedurave të ristrukturimit, të cilat kanë passjellë ndryshime të Strukturës Organizative, në fuqi prej vitit 2016, miratuar me Urdhrin nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore".

Me konkretisht, ndryshimet strukturore të ATQ, u pasqyruan në zbatim të:

- 1. Urdhrit nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore";**
  - 1.1. Urdhri nr. 106, datë 21.03.2019, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për miratimin e organigramës të Administratës Tatimore Qendrore".*
- 2. Urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" të ndryshuar;**
  - 2.1. Urdhri nr. 107, datë 13.05.2019, i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, "Për miratimin e organigramës të Administratës Tatimore Qendrore".*

Ndryshimet strukturore, në zbatim të Urdhrit nr. 49, datë 27.02.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", erdhën si pasojë dhe

në zbatim të Vendimit nr. 673, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”, ku përcaktohej se funksionet e menaxhimit të sistemeve të teknologjisë së informacionit do të kryhen nga njësitë organizative në përbërje të AKSHI, numri plan i personelit të ATQ, nga 1569 do të bëhet 1512 punonjësish/nëpunësish, prej të cilëve 1102 janë nëpunës civil dhe 410 punonjës të cilë trajtohen me dispozita të Kodit të Punës.

Ndryshimet strukturore, në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" të ndryshuar, erdhën si pasojë dhe në zbatim të Rekomandimeve të FMN-së dhe Rekomandimeve të KLSH-së, të cilat nuk ndikuan në numrin e përgjithshëm të personelit të ATQ, mbeten 1512 numër plan punonjësish/nëpunësish, prej të cilëve 1115 janë nëpunës civil dhe 397 punonjës të cilë trajtohen me dispozita të Kodit të Punës.

Ndryshimet kryesore në këtë strukturë i referohen:

- Centralizimit të Sektorit të Transferimit të Çmimit në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj.
- Sektori i Përmbushjes, në Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut, u emërtua Sektori i Hartimit të Strategjive për Trajtimin e Riskeve.
- Sektori i Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave në DTM tashmë do të jetë Drejtoria e Analizës dhe Kontabilitetit të të Ardhurave dhe do të ketë në përbërje 2 (dy) sektorë, atë të Analizës dhe Kontabilitetit (1+2) dhe Sektorin e Analizës të Riskut, kjo e fundit rekomandim i FMN.
- Centralizimi i Sektorëve të Analizës në Drejtoritë e Hetimit Tatimor, në rajone u përqëndruan në DPT dhe Sektorët e Zbatimit u emërtuan Sektorët e Monitorimit Territorial,

Në zbatim të ndryshimeve strukturore, të Vendimeve nr. 11348 Prot., datë 06.06.2019 të Komisionit të Ristrukturimit të ngritur në zbatim të Udhëzimit nr. 1, datë 1.3.2016 të Departamentit të Administratës Publike, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e Komisionit të Ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, me Urdhrin nr. 32, datë 10.05.2019 të DAP “Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore”, janë përpiluar dhe zbardhur në total 397 akte administrative.

### **REKOMANDIME TË FMN-së**

1. Konsolidimi i tre njësive ekzistuese të çmimeve të transferimit në një njësi të DTM, brenda DTM;

*Në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", struktura e transferimit të çmimit, ushtronte funksione në përbërje të Drejtorisë së Kontrollit Tatimor në DPT, DRT Tiranë dhe DTM. Në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" të ndryshuar, strukturat e transferimit të çmimit u konsoliduar brenda strukturës së Drejtorisë së Kontrollit Tatimor, në DTM – **rekomandim i zbatuar.***

2. Riintegrimi i Inspektimit në Terren, duke përfshirë edhe grupin e punës në strukturën e Kontrollit;

*Në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", ushtronin detyra funksionale sektorët e zbatimit, në përbërje të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, DRT (Rajone). Në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" të ndryshuar, strukturave të zbatimit u ndryshohet emërtesa, në Sektorët e Monitorimit Territorial, brenda Drejtorive të Hetimit Tatimor – **rekomandim i zbatuar.***

3. Konsolidimi i njësive të analizave të Drejtorive të Hetimit në një njësi të vetme që mbështet të gjitha Drejtoritë;

*Në zbatim të Urdhrit nr. 126, datë 02.08.2016 të Kryeministrit "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore", struktura e analizës, ushtronte funksione në përbërje të Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT, DRT (Rajone). Në zbatim të Urdhrit nr. 86, datë 03.05.2019, të Kryeministrit "Për disa ndryshime në urdhrin nr.126, datë 02.08.2016, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës organizative dhe të numrit të përgjithshëm të personelit të Administratës Tatimore Qendrore" të ndryshuar, strukturat e analizës u konsoliduar brenda strukturës së Drejtorisë së Hetimit Tatimor në DPT – **rekomandim i zbatuar.***

4. Rishikimi i organizimit dhe strukturave drejtuese të zyrave më të vogla rajonale për të identifikuar mundësitë për reduktimin e shpenzimeve të menaxhimit;

5. Rishikim i strukturës organizative të DTM-së me qëllim ndarjen me te mire te inspektoreve te kontrollit nga zyra dhe gjithashtu ndarja e kontrollit ne vend sipas industrive; - prekur ne draft-strukture;
6. Përshpejtimi i procesit të rekrutimit të personave kryesorë, emërimi sa më shpejt zëvendës drejtorit në bashkëpunim me Ministrinë për Inovacionin dhe Administratën Publike.

*Në zbatim të dispozitave ligjore në fuqi dhe ndjekjes së procedurave për plotësimin e vendeve vakante, me vendimin nr. 3542 Prot., datë 12.06.2019, protokolluar me tonën nr. 11704 Prot., datë 12.06.2019, të Departamentit të Administratës Publike, është mundësuar emërimi dhe plotësimi i pozicionit të punës të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm Territorial. - **rekomandim i zbatuar.***

### **AKTIVITETE TË REJA NË VITIN 2020**

1. Rishikimi i Treguesve Kyç të Performancës për hetimin tatimor dhe strukturat që do të merren me verifikimin e koordinimin territorial, i periodicitetit dhe targetit. Përcaktimi i KPI edhe për strukturat që ende nuk kanë një listë të miratuar të tillë.
2. Ballafaqimi i vlerësimit të rezultateve në punë me realizimin e KPI dhe automatizimi i këtij procesi, me qëllim shmangien e subjektivitetit.
3. Finalizimi i procesit të ndryshimeve strukturore dhe kërkimi nga secila drejtori respektive e një sistemi të matjes së eficiencës së strukturës në varësi, duke patur si qëllim mbulimin e kostove dhe shpenzimeve që administrata/institucioni vë në dispozicion për një pozicion pune.
4. Krijimi i një databaze me të dhënat për kualifikimet e çdo punonjësi në administratën tatimore, dërgimi nga strukturat që merren me trajnimet jashtë vendi të informacioneve mbi baza periodike. Detyrimi i çdo punonjësi të trajnuar jashtë vendit, të përgatisë një raport përmbledhës për njohuritë e përfituara në trajnim/ëorkshop etj dhe si i shërbën ky i fundit pozicionit të tij të punës, duke skeduluar shpërndarjen e kësaj njohurie në takime me fokus grupe të përbërë nga punonjës të AT.
5. Lidhja e partneriteteve me Universitetet në vend lidhur me zhvillimin e trajnimeve, intershipeve 3-6 muaj dhe në bashkëpunim me Akademinë Fiskale, sigurimi si lektorë i pedagogëve me eksperiencë nga këto universitete, me qëllim plotësimin e boshllëqeve në

aftësi të stafit. Në këtë kuadër është kërkuar dhe asistencë e huaj, nga administratat tatimore moderne e të zhvilluara.

### **TRAJNIMI DHE NGRITJA E KAPACITEVE TË BURIMEVE NJERËZORE**

Gjatë vitit 2019 janë trajnuar gjithsej **1367 punonjës**, në zbatim të plotë të programit vjetor të trajnimeve për vitin 2019 të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve, me vendimin Nr.2, datë 08.01.2019 "Për Miratimin e Programit Vjetor të Trajnimit të Administratës tatimore Qendrore për Vitin 2019", bazuar në kalendarin e trajnimeve sipas temave të miratuar nga Bordi i MFE me vendimin nr. 2, datë 17.04.2019, në bashkëpunim me QTATD/ASPA.

1. Zbatimi i plotë i programit përfshin:

- a. Trajnimi i nëpunësve/punonjësve të rinj dhe punonjësve ekselent të rekrutuar në administratën tatimore gjatë vitit 2019. Temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit që lidhen me përfitime njohurive baze për çështjet tatimore (Sherbimin tatimpagues, mbledhjen me force, kontrollin tatimor etj), organizimin e administratës tatimore, marrëdhëniet e punës në administratën tatimore, kodin e etikës, konfliktin e interesit si dhe për mashtrimet në fushën e tatimeve (evazioni fiskal)
- b. Trajnimi i nëpunësve ekzistues për temat e trajnimit të zhvilluara sipas kalendarit të miratuar nga QTATD (bordi MFE) që lidhen me çështjet tatimore.
- c. Trajnimi i nivelit drejtues (Drejtor Drejtorie/Përgjegjës Sektori) për menaxhimin e punës i zhvilluar pranë ASPA si dhe pranë QTATD me temat e trajnimit sipas kalendarit të trajnimeve.
- d. Trajnimi i punonjësve të strukturave të hetimit tatimor për legjislacionin tatimor.

#### **Trajnime të tjera jashtë programit të planifikuar dhe zhvilluara janë :**

2. Zhvillimi i trajnimeve të tjera bazuar në nevojat e strukturave të hetimit tatimor në bashkëpunim me institucionet e pavarura (Prokurorinë) me temë: "Evazioni fiskal në fushën e tatimeve".
3. Trajnimin me strukturat e zbatimit (monitorimit në terren) me temë " Ëeb-Gis për regjistrimin dhe kontrollin e bizneseve të taksueshme"
4. Trajnime pranë ASPA për temën: "Kujdesi ndaj Klientit dhe Komunikimi" me nëpunës të strukturave të shërbimit tatimpagues.
5. Në bashkëpunim me QTATD/ASPA, për vitin 2019 përfundoi trajnimi dhe testimi për 47-nëpunës në periudhë prove, të cilët kaluan testimin dhe kanë përfituar certifikatën pranë ASPA.

Për vitin 2020 janë evidentuar nevojat dhe Drejtori i Përgjithshëm me vendimin Nr. 1 , datë 20.01.2020 ka miratuar programin e trajnimeve duke përcaktuar drejtimet e synuara, organizimin dhe intsitucionet e bashkëpunimit për zhvillimin e tij. Ky program është përcjell me shkresën nr. 1227, datë 20.01.2020 prane QTATD me qëllim paraqitjen për miratimin e tij nga Bordi i Akademisë Fiskale, pranë MFE.

### **MASAT DISIPLINORE**

#### **a. Procedura disiplinore të filluara dhe përfunduara në 2019.**

Në lidhje me procedurat disiplinore të trajtuara për vitin 2019, janë filluar ecuritë disiplinore për 163-nëpunës/punonjës të administratës tatimore qendrore.

Janë shqyrtuar dhe zbardhur vendimet e përfundimtar nga Komisioni i Disiplinës për 51 - ecuri disiplinore për nëpunës civil që trajtohen sipas dispozitave të ligjit mbi shërbimin civil, vendime të cilat janë përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore organeve kompetente brenda afateve të parashikuara në ligj.

Tre masa disiplinore janë trajtuar nga eprori direkt.

Për punonjës që trajtohen me dispozitat e Kodit të Punës janë zbardhur gjithsej 90 vendime sipas procedurave të parckatuara në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 65/2, datë 14.05.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit, largimit dhe marrjen masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor”.

Në mënyrë të detajuar trajtohen në tabelën e mëposhtme:

**Tabela 1. Masat disiplinore të punonjësve Administratën Tatimore Qendrore për vitin 2019**

<b>PROCEDIMET DISIPLINORE NË ADMINISTRATEN TATIMORE</b>		
<b>VENDIME TË DHËNA GJATË VITIT 2019</b>		
<b>Vendime të vitit 2019</b>		
<b>A. Masa të dhëna për nëpunës të shërbimit civil:</b>		<b>54</b>
1	Largim nga Sherbimi Civil	2
2	Mbajtje page	1
3	Pezullim ngritje ne detyre	10
4	Nxjerrje jashte juridiksioni	3
5	Verejtje	3
6	Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	35
<b>B. Masa të dhëna për punonjësit me Kod Pune:</b>		<b>90</b>

1	Zgjidhje e menjëhershme e kontratës së punës	9
2	Verejtje me shkrim	42
3	Verejtje me paralajmerim për largim nga puna	35
4	Ndërprerje e Ecurisë disiplinore	4
<b>GJITHSEJ</b>		<b>144</b>
<b>Në proces</b>		19
<b>TOTAL FILLIM ECURIE DISIPLINORE</b>		<b>163</b>

### **TË DHËNAT PËR VLERËSIMET E REZULTATEVE NË PUNË PËR VITIN 2019**

Për të dy gjashtë mujorët e vitit 2019 procesi i vlerësimit të rezultateve të punës, është përmbyllur për të gjithë nëpunësit/punonjësit e administratës tatimore konform procedurave të përcaktuara në ligjin Nr.152, datë 30.05.2013 ‘Për nëpunësit civil’, dhe VKM 109, datë 03.05.2014 (i ndryshuar), VKM Nr. 252/2016, si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve Nr. 65/2, datë 14.05.2019 “Për miratimin e Rregullores “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit, emërimit, vlerësimit, largimit dhe marrjen masave disiplinore për punonjësit e strukturave të hetimit tatimor” për strukturat e hetimit tatimor.

- a. Sipas informacionit që disponojmë nuk kemi asnjë rezultat vlerësimi të ankimuar pranë gjykatës kompetente.

Tabela 2. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 mujori I 2019

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Specialist	208	51	152	5	0
2	Inspektor	527	116	403	8	0
3	Përgjegjës Sektori	91	45	45	1	0
4	Drejtor Drejtorie	37	17	19	1	0
5	Drejtor Rajonal	14	4	8	2	0
6	Zv.Drejtor i Përgjithshëm	1	1	0	0	0
7	<b>GJITHSEJ</b>	<b>878</b>	<b>234</b>	<b>627</b>	<b>17</b>	<b>0</b>

Procesi i vlerësimit të punës për 6-mujorin e dytë të vitit 2019, ka përfunduar sipas afateve ligjore dhe aktualisht jemi në fazën e hedhjes në sistemin HRMIS dhe administrimit në dosjet e personelit.

Tabela 2. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 –muji II 2019

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Specialist	<b>208</b>	70	132	6	0
2	Inspektor	<b>524</b>	117	396	11	0
3	Përgjegjës Sektori	<b>84</b>	43	39	2	0
4	Drejtor Drejtorie	<b>32</b>	18	14	0	0
5	Drejtor Rajonal	<b>14</b>	0	10	4	0
6	Zv.Drejtor Pergj	<b>3</b>	3	0	0	0
6	<b>GJITHSEJ</b>	<b>865</b>	<b>251</b>	<b>591</b>	<b>23</b>	<b>0</b>

Tabela 3. Vlerësimet e 6-mujorit I 2019 të strukturës së Hetimit Tatimor në Administratën Tatimore

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Inspektor	<b>207</b>	47	123	36	1
2	Përgjegjës Sektori	<b>8</b>	6	1	1	0
4	<b>GJITHSEJ</b>	<b>215</b>	53	124	37	1

Tabela 4. Vlerësime 6 muji II 2019 të strukturës së Hetimit Tatimor në Administratën Tatimore

Nr	Pozicioni punes	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
			Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	Inspektor	<b>202</b>	55	125	19	3
2	Përgjegjës Sektori	<b>13</b>	12	1	0	0
3	<b>GJITHSEJ</b>	<b>215</b>	67	126	19	3

Tabela 5. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore.

Nr	Gjithsej	Niveli i vlerësimit			
		Shume mire (1)	Mire (2)	Kenaqshem (3)	Jo kenaqshem (4)
1	110	64	41	5	0

## XII. BUXHETI DHE FINANCA

Tabela 1. Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

								ne 000/leke
Programet		Shpenzimet e Ministrisë/Institucionit						
		(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
Titulli	Emertimi	i vitit paraardhes Viti 2018	Viti 2019	Plan Fillestar Viti 2019	Plan i Rishikuar Viti 2019	Plani 2019	12 Mujori 2019	
1140	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore	2,664,595	3,199,001	3,202,401	3,187,401	3,187,401	2,870,220	-317,181.0
0002	Programi 2	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0003	Programi 3	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0004	Programi 4	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
0005	Programi 5	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
.....	.....							
Totali i Shpenzimeve te Ministrise		2,664,595.0	3,199,001.0	3,202,401.0	3,187,401.0	3,187,401.0	2,870,220.0	-317,181.0
Shpenzime nga te Ardhurat Jashte limitit								
Totali		2,664,595.0	3,199,001.0	3,202,401.0	3,187,401.0	3,187,401.0	2,870,220.0	-317,181.0

Tabela 2. Raporti i Shpezimeve sipas artikujve buxhetore

Periudha e Raportimit: 12 Mujori 2019								ne 000/leke
Emri i Grupit	Ministria e Financave						Kodi i Grupit	10
Programi	Menaxhimi i te Ardhurave Tatimore						Kodi i Programit	1140
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Fakti	Diferenca
		i vitit paraardhes	Plan Viti 2019	Plan Fillestar	Plan i Rishikuar	Plani i Periudhes/progresiv	i Periudhes/progresiv	

		Viti 2018		Viti 2019	Viti 2019			
600	Paga	1,313,263	1,451,000	1,451,000	1,357,000	1,357,000	1,298,563	- 58,437
601	Sigurime Shoqërore	217,997	372,000	372,000	230,000	230,000	215,722	- 14,278
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	806,631	421,741	421,741	626,192	626,192	574,146	- 52,046
603	Subvencione							-
604	Transferta Korente të Brendshme							-
605	Transferta Korente të Huaja	1,187	1,260	1,260	1,260	1,260	1,120	- 140
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	2,509	-	3,400	34,949	34,949	31,764	- 3,185
<b>Nen- Totali</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>2,341,587</b>	<b>2,246,001</b>	<b>2,249,401</b>	<b>2,249,401</b>	<b>2,249,401</b>	<b>2,121,315</b>	- <b>128,086</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara	5,160	6,210	6,210	6,210	6,210	5,553	- 657
231	Kapitale të Trupëzuara	317,847	946,790	946,790	931,790	931,790	743,352	- 188,438
232	Transferta Kapitale							-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te brendshem</b>	<b>323,007</b>	<b>953,000</b>	<b>953,000</b>	<b>938,000</b>	<b>938,000</b>	<b>748,905</b>	- <b>189,095</b>
230	Kapitale të Patrupëzuara							-
231	Kapitale të Trupëzuara							-
232	Transferta Kapitale							-
<b>Nen - Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale me financim te huaj</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>	<b>-</b>
<b>Totali</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>323,007</b>	<b>953,000</b>	<b>953,000</b>	<b>938,000</b>	<b>938,000</b>	<b>748,905</b>	- <b>189,095</b>
<b>Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti</b>		<b>-</b>					<b>-</b>	
<b>Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)</b>		<b>2,664,594</b>	<b>3,199,001</b>	<b>3,202,401</b>	<b>3,187,401</b>	<b>3,187,401</b>	<b>2,870,220</b>	- <b>317,181</b>

Tabela 3. Projektet e investimeve

Kodi projektit	Emertimi i projektit	Vlera e plotë	Viti i fillimit	Viti i përfundimit	Buxheti	Plani i buxhetit viti 2019	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i vitit deri në periudhën aktuale	REALIZIMI për periudhën e raportimit (4-mujore/vjetore)	REALIZIMI PROGRESIV nga fillimi i projektit deri në periudhën aktuale	Komente
		e	të	të	Kontraktuar					
		projektit	projektit	projektit						
18AV806	Krijimi i një mjedisi të ri dhomë serverash(data center), sistem tefonik voip dhe monitorimi i qendëruar për DPT/DRT	170,000	2019	2021	-	76,000	74,400	74,400	74,400	Likujduar kontrata per projektin
18AV903	Rikonstruksion DRT Tiranë	5,000	2019	2019	-	5,000	-	-	-	Nuk u arrit te kryhet procedura
18AV904	Rikonstruksion DRT Dibër	6,000	2019	2019	-	6,000	-	-	-	Nuk u arrit te kryhet procedura
M100024	Blerje paisje elektronike, kompjuterike ( fond I ngrire)	4,000	2019	2019		4,000				Nuk u arrit te kryhet procedura
M100255	Pagesa e kontributit vjetor FISCALIS 2020	31,600	2015	2020	31,600	6,210	5,553	5,553	23,117	Likujduar kontributi vjetor 2019
M100500	Permiresimi I modulit te menaxhimit te kontrollit te faturimit	1,727,792	2018	2020	1,727,792	840,790	668,952	668,952	838,999	Projekt iniciuar ne 2018, ne proces likujdimi sipas kontrates

### XIII. DREJTORIA E ADMINISTRATES DHE PROKURIMEVE

#### Lista e Shkurtimeve

- DAP- Drejtoria e Administratës dhe Prokurimeve
- SPE- Sistemi i prokurimet elektronik
- APP – Agjencia e Prokurimit Publik
- KPP- Komisioni i Prokurimit Publik
- DBF- Drejtoria e Buxhetit dhe Finances
- AKSHI- Agjencia kombëtare e Shoqërisë së Informacionit

Drejtoria e Administrates dhe Prokurimeve garanton mjetet dhe kushtet e përshtatshme të punës për punonjësit e Administratës Tatimore për realizimin e detyrave të tyre funksionale. Kjo Drejtori bashkëpunon punën me Drejtoritë Rajonale Tatimore dhe vepron si pikë kontakti ndërmjet Aparatit të DPT-s dhe DRT-ve për të ofruar mbështetje.

- Disa nga detyrat e kësaj Drejtorie janë:
- Sigurimi i kushteve normale të administrates tatimore në DPT dhe DRT.
- Realizimi i procedurave të prokurimet bazuar në regjistrin e prokurimeve të miratuar cdo vit kalendarik bazuar në Ligjin për buxhetin.
- Manaxhimi i Dokumentacionit Tatimor (letrave me vlere) të cilat planifikohen, prodhohen dhe shperndahen sipas kërkesave të DRT-ve dhe Operatorëve Ekonomik.
- Ruajtja dhe administrimi i aseteve sipas legjislacionit në fuqi.
- Ndjekja e marrdhënieve kontraktuale për realizimin e kontratave që sigurojnë mbështetje logjistike të Administratës Tatimore

<b>Drejtoria e Administrates dhe Prokurimeve (Gjithsej punonjes)</b>	
Drejtori	
<b>Spektori i Administrates</b>	
Përgjegjës Spektori.	
Spektalist	VAKANT
Protokollist	
Protokollist	
Protokollist	
Arshivist	

Magazinier	
Magazinier	
Punonjes Informacioni	
Shofer	
Shofer	
Shofer	
Shofer	
Shofer	
Shofer	
Shofer	
Korrier	
Punonjes Pastrimi	
Punonjes Pastrimi	
Punonjes Pastrimi	
Spektori i Prokurimeve	
Përgjegjës Spektori	
Specialist	
Specialist	VAKANT

*Mungon staf për mirëmbajtjen e objektit*

*Mungon një specialist për administratën*

## **1. Objektivat e Drejtorise për vitin 2019**

Objektivat të shprehur bazuar në Planin Strategjik të Administratës Tatimore për periudhën 2017-2021 në 3 shtylla për çdo Drejtori :

- Objektivat strategjike

*Sigurimi i kushteve të përshtatshme të punës dhe ambienteve moderne për punonjësit e Administratës;*

*Sigurimi i mjeteve të përshtatshme dhe profesionale të punës;*

- Treguesit kryesorë të performancës

*Përmirësimi i planifikimit strategjik, buxhetimit, planifikimi operacional, menaxhim i projekteve dhe planifikimit të burimeve;*

- Lidhja e objektivave me rekomandimet e TADAT

-

**2. Aktivitet e programuara dhe realizuar gjate vitit 2019 ne funksion te realizimit te objektivave.**

- Realizimi i procedurave të prokurimet bazuar në planifikimin e regjistrit të prokurimeve 2019.
- Ngritja grupit te punes per klasifikimin e dokumenacionit te arkives ne DRT e DPT.  
Klasifikimi i dokumentacionit te Arkives sipas afateve te ruajtjes. Hedhja e dokumentacionit te klasifikuar ne sisteme te automatizuara. Dorezimi i materialeve te perpunuara ne Arkivin e Shtetit.
- Ndjekja e marredhenieve kontraktuale per realizimin e kontratave qe sigurojne mbeshtetjen logjistike te Administrates Tatimore.
- Sigurimi kushteve normale te punes se administrates se aparatit te Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve dhe Drejtorive Rajonale Tatimore
- Administrimi dhe shperndarja e baze materiale/dokumentacionit tatimor.

**3. Aktivitete jo te parashikuara ne planifikimin fillestar, por te realizuara gjate vitit 2019.**

- Krijimi i nje mjedisi te ri dhomë serverash(data center),sistem telefonik voip dhe monitorimi i qëndërzuar për DPT/DRT, planifikuar me pak ndryshuar vlere me kerkese te DBF rritur vlere. Realizuar .

**4. Aktivitete te parealizuara ose te paperfunduara (arsyet dhe afatet e perfundimit)**

- Rikonstrukcion i DRT Tiranë
- Rikonstrukcion i DRT Dibër
- Blerje pajisje Elektronike(Fond i ngrirë)

Projekte të kërkuara per rialokim nga DBF dhe të pa realizuara per arsye kohore pasi kerkesa ka ardhur ne DAP në datën 18.11.2019, kohë e pa mjaftueshme për realizimin e këtyre projekteve.

Blerje pajisje elektronike e pa realizuar nga AKSHI , kthyer pergjigje per mungese kohe dhe bllokimin e procedurave nga termeti.

**5. Sa dhe si ndikuan keto aktivitete ne arritjen e objektivave te percaktuara.**

- Dy rikonstrukSIONET nuk kanë ndikuar pasi Dibra ska qënë e planifikuar as Tirana. Ndërkohë që me tërmetin e datës 26.11.2019 do të na digjeshin këto fonde pasi DRT Tiranë ka dale e pabanueshme.
- Për blerje pajisje elektronike ndikon negativisht pasi kompjutrave ju eshte rritur amortizimi dhe për vitin 2020 përsëri nuk ka planifikim për blerje .

#### **6. Problematikat e hasura gjate realizimit te aktiviteteve gjate vitit 2019.**

- Procedura “ Ruajtje Objektesh” pesë lote i vonoi KPP në shqyrtimin e ankesave me arsye mungese personeli.
- Procedura Riparimi i Automjeteve u bllokua me daljen e shkreses se MFE per bllokimin e procedurave në proces prokurimi dhe pse ne i nisëm shkresë MFE per të na lejuar vazhdimin e kësaj procedure për arsye se këto janë mjete që i shërbejnë DR.Hetimit dhe ndikojnë në realizimin e planit. Këto makina janë në limitet e shërbimeve që duhen kryer.

#### **7. Objektivat e Drejtorise për vitin 2020**

- Objektivi i DAP është të garantoj mjetet dhe kushtet e përshtatshme të punës për punonjësit e Administratës Tatimore për realizimin e detyrave të tyre funksionale.

#### **8. Aktivitet e parashikuara te realizohen per vitin 2020 ne funksion te realizimit te objektiveve.**

Janë procedurat e mëposhtme:

- Shërbime te sigurimit dhe ruajtjes 2020
- Shpenzime per mirembajtje te mjeteve te transportit
- Shpenzime blerje, gome
- Karburant dhe vaj
- Shpenzime materiale të tjera zyre (Toner)
- Shpenzime blerje (leter)
- Shpenzime blerje ( kancelari)
- Shpenzime per prodhimin e pullave te takses dhe tarifes dhe dokumentacioni tatimor.
- Sigurimi i godinave te AT nga fatkeqsite natyrore

#### **9. Te specifikohen projekte te ndermarra aktualisht ne bashkepunim me organizma nderkombetare dhe nevojat e Drejtorise per 2020.**

#### **10. Kërkesat e Drejtorise per vitin 2020 per:**

- Trajnime
- Per infrastrukture IT

*Blerje pajisje elektronike*

- Per financim me buxhet
- Per ambjente

Projekt Magazine DPT

Projekt Rikonstruksimin e DRT Fier

Projekt shkallët e emergjencës civile

- Te tjera kerkesa

Shtimin e personelit në DPT me puntore mirëmbajtje dhe shërbimi dhe plotësimi i vendeve vakante ne DAP.

## XII. QENDRA E PAGESAVE

Drejtoria Qendra e Pagesave monitoron funksionimin e sistemit të pagesave të detyrimeve tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, me qëllim lehtësimin e procedurave të pagesës nga tatimpaguesit, lehtësimin e punës me bankat e nivelit të dytë për përgatitjen e informacionit në lidhje me këto pagesa dhe përmiresimin e përpunimit të të dhënave të pagesave për qëllime të administratës tatimore.

Qendra e pagesave ne perputhje me Objektivin e Planit Strategjik “Garantimi i asistencës për përmbushjen vullnetare”– duke ofruar shërbime cilësore dhe duke ndikuar në reduktimin e barrës administrative në pagesën e detyrimeve tatimore dhe kontributeve shoqërore”ka mundësuar arritjen e rezultateve si me poshte”

1. Raportimin në kohë sa më të shpejtë i pagesave të arkëtuara në buxhetin e shtetit pranë Drejtorise se Kontabilitetit dhe Analizes si dhe strukturave drejtuese ne DPT.
2. Identifikimin i pagesave pezull dhe sistemimi i tyre në llogarinë e duhur të tatimpaguesit.

Gjate vitit 2019 Qendra e Pagesave ka ndjekur, pergatitur dhe raportuar ne kohe dhe me sakte si informacionin mbi pagesat e kryera ne bankat e nivelit te dyte dhe ne thesar lidhur me te ardhurat tatimore dhe kontributet e detyrueshme te sigurimeve shoqerore dhe shendetesore. Puna e kesaj drejtorie gjate vitit 2019 eshte fokusuar ne:

- Marrjen dhe Krahasimin e ekstraktit bankar me të dhënat e ardhura elektronikisht nga sistemi i thesarit.
- Komunikimin me Drejtorise e Teknologjisë se Informacionit dhe Komunikimit ne funksion te mbarevajtjes se punes dhe sakte si se informacionit. Numri I komunikimeve elektronike per zgjidhjen e problematikave te konstatuara gjate vitit 2019 ka qene rreth 190.
- Sistemimin e pagesave pezull në bazë të Akt-Marrëveshjes mes Ministrisë së Financave dhe bankave të nivelit të dytë, duke komunikuar në mënyrë permanente me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit. Më saktësisht, janë sistemuar 860 raste për vitin 2019.

- Përgatitjen e raporteve ditore , mujore dhe progresive të të ardhurave të tatimore dhe kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe për çdo drejtori rajonale tatimore pas räkordimit të të ardhurave me bankat e nivelit të dytë dhe degën e thesarit si dhe vënia e këtyre raporteve në dispozicion të Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Analizës dhe strukturave drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve .
- Komunikimin e vazhdueshëm me bankat e nivelit të dytë në zbatim të Akt- Marrëveshjes për të gjitha sqarimet për rastet e sistemimeve të pagesave që nuk mund të identifikohen nga administrata tatimore apo të ndonjë problemi të lindur gjatë zbatimit të kësaj akt marrëveshje me bankat e nivelit të dytë. Gjatë vitit 2019 janë kryer 95 komunikime elektronike me bankat e nivelit të dytë dhe me tatimpaguesit për problematika të ndryshme.

## XVIII. DIBA

Në lidhje me masat e mëtejshme me qëllim parandalimin dhe goditjen e rasteve korruptive Drejtoria e Investigimit të Brëndshëm (Antikorrupsion) bazuar dhe në zbatimin ligjor, gjatë periudhës raportuese janar - dhjetor 2019, *ka kryer verifikimin dhe investigimin për 103 raste të denoncuarra, nga këto:*

- 35 Çështje janë janë rregjistruar dhe investiguar;
- 1 (një) Çështje është referuar në Prokurori (*kaluar për kompetencë*), ku janë përfshirë 3 (tre) punonjës.
- 96 punonjës janë konstatuar me shkelje ligjore dhe janë referuar në Komisionin e Disiplinës:

Në lidhje me rastet e verifikuara dhe të investiguara nga ana jonë , të cilat kanë ardhur nga burime të ndryshme të informacionit por që nuk janë rregjistruar si çështje, janë gjithsej 68 raste, raste të cilat nuk përmbajnë dhe nuk plotësojnë kushtet e mjaftueshme për tu rregjistruar si çështje.

## XVI. Zbatimi i rekomandimeve te nderkombetareve

## Tabela

Tabela 1. Totali DPT 12 Mujori 2018.....	10
Tabela 2. Të ardhurat e realizuara për vitin 2018 sipas DRT-ve (000 leke) .....	12
Tabela 3. Të ardhura nga Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (000 leke) .....	13
Tabela 4. Te ardhura nga Tatimi mbi Fitimin 12 Mujori (000 leke) .....	13
Tabela 5. Te ardhura nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale (000 leke).....	14
Tabela 6. Krahاسimi TAP sipas zerave (000 leke) .....	14
Tabela 7. Të ardhura nga Taksat Kombëtare dhe Tarifa (000 leke).....	15
Tabela 8. Taksat Kombëtare dhe Tarifat sipas llojeve (përfshirë Tarifa Buxhetore) .....	16
Tabela 9. Të ardhura nga Taksa e Qarkullimit dhe Karburantit (000 leke).....	17
Tabela 10. Të ardhurat nga sigurimet shoqërore & shëndetësore.....	17
Tabela 11. Përshkrimi i kontakteve dhe shërbimeve të ofruara 2018.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 12. Përshkrimi i vërtetimeve të lëshuara nga funksioni i shërbimit ..	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 13. Vërtetime të lëshuara nëpërmjet Portalit e-albania .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 14. Rimbursime për kërkesa të mbartura nga viti 2017.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 15. Kërkesat e pranuar gjatë vitit 2018 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 16. Situata e rimbursimit për vitin 2018 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 17. Rimbursimet sipas DRT-ve.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 18. Rezultatet e vitit 2018 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 19. Denoncime/ankesa ne numer .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Tabela 20. Masatdisiplinore të Administratën Tatimore Qendrore për viti 2018 .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>

Tabela 21. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 mujori i parë 2018 **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 22. Vlerësimet e nëpunësve civil në Administratën Tatimore 6 mujori i dytë 2018 **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 23. Vlerësimet vjetore të strukturës së Hetimit Tatimor në Administratën Tatimore ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 24. Vlerësimi vjetor i rezultateve në punë për punonjësit me Kod Pune në Administratën Tatimore..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 25. "Raporti i Shpenzimeve të Programit sipas Artikujve Buxhetorë" (000 leke) .. **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 26. "Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve" (000 leke) ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 27. " "Projektet e investimeve me financim të brendshëm dhe me financim të huaj" (000 leke) ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 28. Regjistri i Prokurimeve për vitin 2018 ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 29. Investimet DPT ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 30. Realizimi i kontratës 2018 së biletave të transportit rrugor me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë" ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 31. Realizimi i kontratës 2018 së pullave me "Shtypshkronjën e Letrave me Vlerë" ..... **Error! Bookmark not defined.**

Tabela 32. Realizimi i kontratës së dokumentacionit tatimor për vitin 2018: **Error! Bookmark not defined.**

## Grafikë

Grafik 1. Struktura e të ardhurave .....	10
Grafik 2. Struktura e borxhit tatimor sipas llojit të tatimit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 3. Borxhi sipas llojit të Tatimit 2017 vs 2018.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 4. Mosha e borxhit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 5. Borxhi sipas statusit të tatimpaguesit .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 6. Verifikimet në numër bazuar në plane operacionale dhe në ndjekje të shkresave sipas cdo Drejtorie Hetimi Tatimor.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 7. Masa administrative në numër të vendosura për ata tatimpagues që nuk përmbushin legjislacionin tatimor.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 8. Shkelje në vlerë sipas rajoneve. ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 9. Referime në prokurori sipas cdo DHT gjatë vitit 2018. ....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 10. Referime të veprave penale në prokurori ndër vite.....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
Grafik 11. Referimet e rasteve sipas prokurorive .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>